



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 mars 2026
Nr. ref.:AGJ3004/26

AKTGJYKIM

në

rastet nr. KO72/26 dhe KO74/26

Parashtrues të kërkesës

KO72/26, Qeveria e Republikës së Kosovës

KO74/26, Arbërie Nagavci dhe 30 (tridhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit [nr.24/2026] të 6 marsit 2026 të
Presidentes së Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa KO72/26 është dorëzuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Albin Kurti në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria).
2. Kërkesa KO74/26 është dorëzuar nga Arbërie Nagavci, Albulena Haxhiu, Salih Zyba, Fahrush Rexhepi, Fatos Geci, Adriana Matoshi, Arbëreshë Hyseni Kryeziu, Arbër Rexhaj, Vigan Qorrolli, Arsim Ademi, Mimoza Shala, Valon Hoti, Shqipe Isufi, Rozeta Hajdari, Arjeta Fejza, Luan Aliu, Fitim Haziri, Egzon Azemi, Adelina Grainca, Drita

Pajaziti, Liza Gashi, Alban Bajrami, Jeton Raka, Edona Llalloshi, Valon Ramadani, Arijeta Rexhepi, Artan Abrashi, Taulant Kelmendi, Labinotë Demi Murtezi, Bajram Mavriqi dhe Fatmire Kollçaku, deputetë të Kuvendit (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), të grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, (në tekstin e mëtejme të referuar bashkërisht si: parashtruesit e kërkesave).

Akti i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesave kontestojnë kushtetutshmërinë e Dekretit [nr. 24/2026], të 6 marsit 2026, të Presidentes së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Dekreti i kontestuar).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesave është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar për të cilin parashtruesit e kërkesave pretendojnë se i njëjti nuk është në pajtueshmëri me paragrafët 1 dhe 3 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës], nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit], paragrafin 2 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] dhe paragrafin 2 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës.
5. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesave kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të vendosë masë të përkohshme, duke theksuar se *“[...] pezullimi i menjëhershëm i veprimit të Dekretit nr. 24/2026 përbën një masë të domosdoshme për tu parandaluar pasoja potencialisht të pariparueshme për rendin kushtetues, për funksionimin demokratik të institucioneve dhe për interesin publik të Republikës së Kosovës.”*

Baza juridike

6. Kërkesat janë parashtruar bazuar në nënparagrafin 1 të paragrafit 2 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 29 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve), 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) dhe 65 (Kërkesa në pajtim me nënparagrafët 1 dhe 2 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit) të Rregullores së punës Nr.01/2023 së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 7 mars 2026, Gjykata pranoi kërkesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes postës elektronike, të cilën kjo e fundit e regjistroi më 9 mars 2026 me numër KO72/26.
8. Më 9 mars 2026, Kryetari i Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KO72/246] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KO72/26] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Safet Hoxha dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
9. Më 9 mars 2026, përkritazi me rastin KO72/26, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës: (i) Kryeministrin, përkatësisht parashtruesin e kërkesës, duke i kërkuar plotësimin e kërkesës përmes dorëzimit të kopjes së Dekretit të kontestuar; (ii) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja) e cila u njoftua

edhe për mundësinë e dhënies së komenteve; dhe (iii) Kryetaren e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryetarja e Kuvendit), të cilës iu kërkua që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit. Në njoftimet e lartcekura u përcaktua që afati për dorëzimin e komenteve dhe plotësimin e kërkesës është data 11 mars 2026.

10. Të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës në rastin KO72/26 dorëzoi në Gjykatë Aktin e kontestuar.
11. Më 9 mars 2026, gjyqtari Radomir Laban kërkoi përjashtimin e tij nga vendimmarrja lidhur me kërkesën KO72/26. Në të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, refuzoi kërkesën për përjashtim të gjyqtarit Radomir Laban.
12. Më 9 mars 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi propozimin e Gjyqtares raportuese përkitazi me kërkesën KO72/26 për vendosjen e masës së përkohshme. Në po të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, vendosi që (i) të caktojë *ex officio* dhe sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës masën e përkohshme me të cilën ndalohej çdo veprim i Presidentes së Republikës Kosovës në lidhje me Dekretin [nr. 24/2026] të 6 marsit 2026, si dhe të ndalojë çdo veprim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në kohëzgjatjen e përcaktuar sipas pikës II të këtij Vendimi; (ii) të urdhërojë që masa e përkohshme hyn në fuqi më 9 mars 2026, në kohëzgjatje deri më 31 mars 2026; (iii) t'ua kumtojë këtë Vendim palëve; (iv) të publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe që (v) Vendimi hyn në fuqi më 9 mars 2026.
13. Më 9 mars 2026, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesve të kërkesës nga radhët e deputetëve të grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! përmes postës elektronike, të cilën e regjistroi me numrin KO74/26.
14. Më 10 mars 2026, Kryetari në pajtim me paragrafin 1 të rregullit 32 [Bashkimi dhe ndarja e kërkesave] të Rregullores së punës, përmes Urdhrit [KO72/26 dhe KO74/26], urdhëroi bashkimin e kërkesës KO74/26 me kërkesën KO72/26. Bazuar në paragrafin 3 të rregullit të lartcekur, për kërkesat e bashkuara, Gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues mbetet në përbërje të njëjtë, siç është përcaktuar për kërkesën e parë, përkatësisht atë KO72/26.
15. Më 10 mars 2026, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës KO74/26 dhe bashkimin e kërkesës KO74/26 me kërkesën KO72/26.
16. Në të njëjtën ditë, Gjykata poashtu njoftoi për regjistrimin e kërkesës KO74/26 dhe bashkimin e kërkesës KO74/26 me kërkesën KO72/26: (i) Presidenten (ii) Kryetaren e Kuvendit, të cilës iu kërkua që të njoftojë deputetët lidhur me kërkesën; dhe (iii) Kryeministrin. Presidentja, Kryeministri dhe Kryetarja e Kuvendit po ashtu u njoftuan se mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën KO74/26, nëse kanë, deri më 13 mars 2026.
17. Më 11 mars 2026, Paparaci Media dorëzoi në Gjykatë kërkesë për t'u paraqitur në cilësinë e *Amicus Curiae* në lidhje me çështjen e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar.
18. Më 12 mars 2026, Presidentja dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dorëzuan komente lidhur me kërkesat KO72/26 dhe KO74/26.

19. Në të njëjtën ditë, Grupit Parlamentar Multietnik dorëzoi komentet lidhur me kërkesat KO72/26 dhe KO74/26 nëpërmjet postës elektronike, të cilat Gjykata i pranoi më 13 mars 2026.
20. Më 13 dhe 16 mars 2026, Gjykata njoftoi për pranimin e komenteve lidhur me kërkesat KO72/26 dhe KO74/26: (i) parashtruesit e kërkesave; (ii) Presidenten; dhe (iii) Kryetaren e Kuvendit.
21. Më 23 mars 2026, Gjykata nuk e miratoi kërkesën e Paparaci Media për t'u paraqitur si *Amicus Curiae* në lidhje me çështjen e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar.
22. Më 26 mars 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese lidhur me pranueshmërinë e kërkesave dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe shqyrtimin e saj në merita. Në të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, vendosi të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë, që Dekreti [nr.24/2026] i 6 marsit 2026, i Presidentes së Republikës së Kosovës nuk prodhon asnjë efekt juridik; (iii) të konstatojë, që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi kanë tridhjetë e katër (34) ditë për të zhvilluar dhe përfunduar procedurën e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës; (iv) të konstatojë, se në rast se Kuvendi dështon të zgjedhë Presidentin brenda periudhës së përcaktuar në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, bazuar në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi shpërndahet *ex constitutione*, dhe për pasojë, zgjedhjet e parakohshme për Kuvend duhet të zhvillohen brenda dyzet e pesë (45) ditësh, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] dhe paragrafin 6 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (v) të konstatojë, që Vendimi i Gjykatës për vendosjen e masës së përkohshme, i 9 marsit 2026 shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij Aktgjykimi; dhe (vi) të konstatojë, që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Përmbledhja e fakteve

23. Më 28 dhjetor 2025, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.
24. Si rezultat i certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më 11 shkurt 2026, u mbajt Seanca Konstituive e Kuvendit, me ç'rast përmes zgjedhjes së Kryetares së Kuvendit dhe nënkryetarëve, Legjislatura e X-të e Kuvendit u shpall e konstituuar. Po të njëjtën ditë, Kuvendi bazuar në përcaktimet kushtetuese, përkatësisht nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës vijoi me zgjedhjen e Qeverisë.
25. Më 5 mars 2026, Kuvendi i Republikës së Kosovës, bazuar në kërkesën e 42 (dyzet e dy) deputetëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, mbajti seancën e jashtëzakonshme me të vetmen pikë të rendit të ditës "*Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës*".
26. Nga procesverbali i seancës së jashtëzakonshme, të 5 marsit 2026, rezultoi se u propozuan 2 (dy) kandidatë për President të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca dhe Fatmire Mullhaxha – Kollçaku.
27. Nga procesverbali i seancës së jashtëzakonshme, të 5 marsit 2026, gjithashtu rezultoi që Kryetarja e Kuvendit konstatoi se në sallë ishin prezent 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë)

deputetë. Rrjedhimisht si rezultat i mungesës së prezencës së 2/3 të deputetëve, Kryetarja e Kuvendit ndërpreu seancën e jashtëzakonshme.

28. Më 6 mars 2026, Presidentja, bazuar në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 dhe paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës nxori Dekretin [nr. 24/26] përmes së cilit theksohet: *“1. Shpërndahet Legjislatura e Dhjetë (X) të Kuvendit të Republikës së Kosovës.”*

Pretendimet e parashtruesve të kërkesave

29. Parashtruesit e kërkesave KO72/26 pretendojnë se Akti i kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 3 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës], nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit], paragrafin 2 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] dhe paragrafin 2 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës.
30. Parashtruesit e kërkesave KO74/26 pretendojnë se Akti i kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 3 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës], nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit], paragrafin 2 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] dhe paragrafin 2 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës.
31. Në vijim, Gjykata fillimisht do të pasqyrojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës KO72/26 dhe më pas do të vijojë me paraqitjen e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës KO74/26.

(i) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në rastin KO72/26

32. Parashtruesi i kërkesës KO72/26 pretendon se: *“[...] shpërndarja e Kuvendit përmes dekretit antikushtetues, pa u shteruar afati 60-ditor, duke ua ndërprerë mandatin deputetëve dhe duke e dërguar Qeverinë në dorëheqje, (shih Ligjin 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, neni 30, par.2, pika 2.1) ku parashihen kufizime të mëdha ligjore në funksionimin e saj (shih po aty, neni 31) përbën shkelje të rëndë të rendit kushtetues, [...]”*
33. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës KO72/26 në kontekst të pretendimeve për shkelje të neneve 4 dhe 7 të Kushtetutës thekson se: *“[...] këto dispozita kushtetuese janë cenuar rëndë përmes dekretit antikushtetues, duke ua ndërprerë mandatin në mënyrë kundërkushtetuese organit legjislativ dhe deputetëve të Kuvendit, si dhe duke ia kufizuar Qeverisë ushtrimin e kompetencave kushtetuese sipas Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi.”*
34. Tutje, parashtruesi i kërkesës KO72/26 pretendon se Akti i kontestuar *“[...] ka cenuar rëndë parimin e sundimit të ligjit, të drejtat dhe liritë e njeriut, ndarjen e pushteteve, si dhe parimin e demokracisë përfaqësuese, duke mos u lejuar të funksionojë atë sipas afatit të parapërcaktuar kushtetues.”*
35. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës KO72/26 thekson se: *“[...] ndërlidhja e neneve kushtetuese të lartcekura si bazë e nxjerrjes së dekretit që kanë dërguar në shpërndarjen e Kuvendit, është plotësisht kundërkushtetuese.”*
36. Më specifikisht, parashtruesi i kërkesës KO72/26 pretendon se sipas përmbajtjes së nenit 86 të Kushtetutës *“[...] kriter i pakapërcyeshëm dhe i patjetërsueshëm për ta*

shpërndarë Kuvendin dhe për ta dërguar vendin në zgjedhje është mosarritja e numrit të mjaftueshëm të votave përmes votimit të përcaktuar në të tri raundet e votimit.”, duke argumentuar se vetëm pas procesit të votimit dhe mosarritjes së numrit të mjaftueshëm të votave, në tri raundet, vendi mund të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme, gjë që në rastin konkret ky proces nuk kishte filluar si rezultat i mospërbushjes së kriterit kushtetues për të hyrë në votim për zgjedhjen e Presidentit, përkatësisht mospjesëmarrjes së numrit të caktuar të deputetëve.

37. Në fund, parashtruesi i kërkesës KO72/26 specifikon që: *[...] kushtetutvënësi ka përcaktuar se Kuvendi shpërndahet automatikisht nëse “brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës”. Siç dihet, procedura për fillimin e zgjedhjes së Presidentit të vendit ka filluar më 05.03.2026, në momentin që Kuvendit i janë paraqitur dy kandidatë për President, konkretisht nga ora 22:00. Sipas nenit 82. Par. 1.3, Kuvendi këtë procedurë duhet ta përfundojë për 60 ditë; nëse kjo nuk realizohet, atëherë Kuvendi automatikisht shpërndahet. Në këtë rast, Presidentja e vendit, duke u bazuar vetëm dhe vetëm në këtë normë kushtetuese, mund ta njoftojë Kuvendin që ai është shpërndarë “ex lege” dhe të shpallë zgjedhjet e jashtëzakonshme.”*

(ii) Pretendimet e parashtruesit të kërkesës KO74/26

38. Parashtruesit e kërkesës KO74/26 theksojnë se: *“Shpërndarja e Kuvendit përbën një nga ndërhyrjet më të rënda në funksionimin e demokracisë parlamentare dhe në ushtrimin e sovranitetit popullor përmes përfaqësimit parlamentar.”*, duke theksuar se kjo kompetencë e kufizuar mund të ushtrohet vetëm në rrethana të përcaktuara qartë nga Kushtetuta, me pretendimin se nuk ishin plotësuar kriteret kushtetuese duke rezultuar në tejkalim të kompetencave kushtetuese.
39. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës KO74/26 pretendojnë se Akti i kontestuar është jo kushtetues, si rezultat i mosarsyetimit përkitazi me aplikimin e dy bazave të ndryshme ligjore për shpërndarjen e Kuvendit duke iu referuar dy afateve të ndryshme, atë 30 ditor nga paragrafi 2 i nenit 86 si dhe afatin 60 ditor nga paragrafi 1.3 i nenit 82, pa justifikuar lidhjen mes tyre.
40. Më specifikisht, parashtruesit e kërkesës KO74/26 theksojnë se: *“[...] Presidentja e ka marrë si të mirëqenë që, me kalimin e afatit të nenit 86, paragrafin 2, nuk mund të vazhdojnë më përpjekjet për zgjedhjen e Presidentit të ri dhe, rrjedhimisht, nuk ka asnjë arsye për të mos e shpërndarë Kuvendin menjëherë pas kalimit të këtij afati. Mirëpo kjo logjikë nuk ka bazë në tekstin e Kushtetutës. Nga fakti që (1) afati i nenit 86, paragrafin 2 ka kaluar, nuk mund të nxirret konkluzioni se (2) ndalohej vazhdimi i procedurës së përzgjedhjes pas këtij afati dhe deri në afatin tjetër të nenit 82, paragrafi 1.3, kur Kushtetuta parashikon shprehimisht shpërndarjen e Kuvendit.”*
41. Tutje, parashtruesit e kërkesës KO74/26 po ashtu pretendojnë se një analogji e njëjtë aplikohet edhe në procedurat e zgjedhjes së drejtuesve të institucioneve tjera të parashikuara me Kushtetutë, përkitazi me zgjedhjen e Avokatit të Popullit, Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Auditori i Përgjithshëm dhe Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, duke argumentuar se në rastet konkret, kalimi i afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës për zgjedhjen e presidentit të ri, nuk nënkupton se duhet të pushojnë të gjitha përpjekjet për ta kryer procedurën edhe pas këtij afati, duke theksuar se *“Deputetët thjesht duhet të vazhdojnë deri në afatin tjetër 60-ditor, sipas nenit 82 paragrafi 1.3, pas kalimit të të cilit Kushtetuta kërkon shprehimisht që Kuvendi të shpërndahet dhe, rrjedhimisht, që të mos ketë më përpjekje.”*

42. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës KO74/26 pretendojnë se: “[...] përcaktim i afatit 60 ditor është normë kushtetuese përmbajtësore dhe detyrim kushtetues, prandaj shërben si sinjal për të nxitur organin përzgjedhës (në këtë rast, Kuvendin) për ta kryer me kohë procedurën e përzgjedhjes dhe , në këtë mënyrë, për të shmangur situatën kur pozita e presidentit mbetet me ushtrues detyre, ose të paktën për të minimizuar periudhën gjatë së cilës mbetet me ushtrues detyre. Këto qëllim të përcaktimit të afatit të nenit 86, paragrafi 2 na japin edhe një arsye tjetër pse Dekreti i Presidentes duhet të anulohet.”
43. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës KO74/26 theksojnë se: “Shpërndarja e Kuvendit pa u zgjedhur presidenti i ri do të shkaktoje një vonim substancial, prej disa muajsh, në procesin e përzgjedhjes, duke marrë parasysh procedurat e tjera deri në konstituimin e Kuvendit. Të gjithë këta hapa janë të domosdoshëm para se të arrihet përsëri te faza e zgjedhjes së presidentit të ri. Kushtetua kërkon që procesi të kryhet sa më shpejt; Dekreti i Presidentes, me pasojat e tij juridike, e ndërpret procesin në ditën e dytë dhe zvarrit rifillimin e tij për muaj të tërë. Këtë të drejtë diskrecionale për ndërprerjen e procedurave të parapara me kushtetutë të pushtetit legjislativ – Kuvendit, Presidentja/i i Republikës së Kosovës nuk e ka.”
44. Parashtruesit e kërkesës KO74/26 specifikojnë se: “[...] çfarëdo numërimi e interpretimi i afatit 60 ditor, përveçse nga dita e nisjes së procedurës, është jashtë gërmës dhe frymës së Kushtetutës dhe jashtë kuptimit dhe funksionit të vet Nenit 82, paragrafi 1, nënparagrafi 3. [...] Përveç kalimit të afatit 60 ditor, ekziston vetëm një rrugë tjetër përmes së cilës moszgjedhja e presidentit rezulton në shpërndarjen e Kuvendit. Kjo rrugë përcaktohet me nenin 86, paragrafi 6 “Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjedhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.”
45. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës KO74/26 pretendojnë se vetëm pas raundit të tretë të votimit, në rastin kur dëshmohet se asnjëri kandidat për president nuk gëzon mbështetjen e shumicës së deputetëve, mund të shpërndahet Kuvendi, duke theksuar se: “vetëm nëse kalojnë 60 ditë pas fillimit të procedurës pa një rezultat pozitiv, ose mbahen tri raunde votimi, duke përfshirë raundin e fundit ku pragu për zgjidhje ulet nga dy të treta në një shumicë të thjeshtë, pa një rezultat pozitiv. Vetëm nëse përmbushet të paktën njëri prej këtyre kushteve, atëherë mund të dalim në përfundimin se e vetmja mundësi për ta përfunduar me sukses procesin e zgjedhjes së presidentit është që të mbahen zgjedhje të reja dhe të konstituohet një legjislaturë e re.”
46. Më tej, parashtruesit e kërkesës KO74/26 theksojnë se “në të drejtën kushtetuese evropiane”, dhe praktikën e Gjykatave Kushtetuese të Gjermanisë, Austrisë dhe Çekisë “shpërndarja e parlamentit konsiderohet një kompetencë e kufizuar dhe e kontrollueshme juridikisht. Gjykatat kushtetuese kanë theksuar se ky instrument nuk mund të përdoret si mjet politik për të kapërcyer procedurat kushtetuese ose për të shmangur përgjegjësinë institucionale.” Në mbështetje të argumenteve tyre, po ashtu theksojnë se dekreti i kontestuar është jokushtetues, nëse procedura kushtetuese nuk është shteruar plotësisht apo nëse shpërndarja përdoret si instrument politik dhe jo si mekanizëm i fundit kushtetues.
47. Në fund, parashtruesit e kërkesës KO74/26 pretendojnë se me Aktin e kontestuar “[...] Presidentja ka tejkaluar qartazi kompetencat e saj, duke u dhënë fund, në mënyrë krejtësisht arbitrare, mandateve të 120 deputetëve të zgjedhur nga populli.”

(iii) *Kërkesat për masë të përkohshme në rastet e bashkuara KO72/26 dhe KO74/26*

48. Parashtruesi i kërkesës në rastin KO72/26 kërkon nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme, duke arsyetuar se “[...] pezullimi i menjëhershëm i veprimit të Dekretit nr.24/2026 përbën një masë të domosdoshme për tu parandaluar pasoja potencialisht të pariparueshme për rendin kushtetues, për funksionimin demokratik të institucioneve dhe për interesin publik të Republikës së Kosovës.”
49. Parashtruesit e kërkesës në rastin KO74/26 po ashtu kërkojnë nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme ndaj Dekretit të kontestuar, me arsyetimin se në rast të mos miratimit të tij “Çdo ditë e këtij pamundësimi të plotë të ushtrimit të pushtetit legjislativ sjell dëme të mëdha dhe të pariparueshme, si për Parashtruesit, për shkak të privimit të plotë nga kompetencat kushtetuese si ligjvënës të Republikës, ashtu edhe për qytetarët e Republikës.”

Komentet e Presidentes

50. Më 12 mars 2026, Presidentja dorëzoi komentet e saj përkitazi me rastet KO72/26 dhe KO74/26.
51. Në këtë drejtim, Presidentja përmes komenteve të dorëzuara pretendon se: (i) Dekreti i kontestuar është në përputhje me Kushtetutën; (ii) afati përfundimtar për zgjedhjen e Presidentit i përcaktuar në paragrafin 2 të nenin 86 është i qartë, përfundimtar dhe imperativ; (iii) Dekreti nuk cenon parimin e ndarjes së pushteteve; si dhe (iv) nuk ka pasur rrethana objektive apo të jashtëzakonshme të cilat do të pamundësonin zgjedhjen e Presidentit të ri para skadimit të afatit përfundimtar.
52. Fillimisht, Presidentja thekson se Dekreti i kontestuar është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke sqaruar se afati i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës për zgjedhjen e Presidentit të ri ka karakter përfundimtar dhe se çdo dispozitë tjetër duhet të interpretohet në harmoni dhe ndërlidhje me këtë afat përfundimtar, sipas së cilës pavarësisht momentit kur fillon procedura e zgjedhjes, e njëjta duhet të përfundojë tridhjetë (30) ditë para skadimit të mandatit të Presidentit aktual.
53. Presidentja thekson se Dekreti i kontestuar “[...] nuk e cenon në asnjë mënyrë parimin e ndarjes së pushteteve. Përkundrazi, ai kontribuon në forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe balancës ndërmjet pushteteve, duke garantuar që Presidentja të përmbushë detyrimin e saj kushtetues për të siguruar funksionimin kushtetues dhe demokratik të institucioneve të Republikës.”
54. Në këtë drejtim, Presidentja thekson se aspektet kushtetuese rreth procedurës së zgjedhjes së Presidentit janë të sqaruara nga Gjykata Kushtetuese, përfshirë (i) kuorumin dhe pjesëmarrjen e deputetëve në procedurën e zgjedhjes së Presidentit, në rastet KO98/11 dhe KO47/16; (ii) kompetencat e Presidentit lidhur me shpërndarjen e Kuvendit, në rastet KO72/20 dhe KO95/20; (iii) interpretimin dhe zbatimin e afateve kushtetuese, rreth konstituimit të Kuvendit në rastet KO124/25 dhe KO193-196/25.
55. Së dyti, përkitazi me afatin përfundimtar për zgjedhjen e Presidentit, Presidentja thekson se i njëjti është i përcaktuar qartë me gjuhën normative të paragrafit 2 të nenit 86 të Kushtetutës, sipas të cilit shprehjet “duhet” dhe “jo më vonë” krijojnë detyrim kushtetues i cili nuk lë hapësirë për interpretim diskrecional, dhe përtej kufirit të përcaktuar “tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual”.

56. Në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesave për relativizimin e rëndësisë së afatit përfundimtar të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës, Presidentja thekson se: “[...] Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin nr. KO124/25, ku ka trajtuar çështjen e konsistimit të Kuvendit, ka theksuar rëndësinë e respektimit të afateve gjatë akteve kushtetuese, duke gjetur se mosrespektimi i tyre “do të relativizonte rendin kushtetues, respektivisht Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe do të nënkuptonte tolerim të bllokimit institucional, në kundërshtim me natyrën funksionale të një demokracie të udhëhequr nga parimet e demokracisë dhe sundimit të ligjit.” (Aktgjykimi KO124/25, paragrafi 145), duke vënë theksin se edhe në rastin konkret, “çdo lejim i zgjedhjes së Presidentit të ri jashtë afatit imperativ të nenit 86(2) do të përbënte madje rishkrim të Kushtetutës”.
57. Tutje, Presidentja thekson se rëndësia e respektimit strikt të afateve kushtetues i kontribuon dhe është e lidhur ngushtë me: (i) zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese; (ii) parimin e sigurisë juridike dhe sundimin e ligjit; (iii) administrimin e drejtësisë dhe parashikueshmërisë juridike, duke argumentuar se në të kundërtën “[...] neglizhimi dhe relativizimi i një afati kushtetues dhe zbehja e peshës së tyre, duke ofruar alternativë që mos respektimi i afati nuk prodhon pasojë, do të krijonte standard të rrezikshëm për sigurinë juridiket në Republikën e Kosovës”.
58. Në këtë drejtim, Presidentja thekson se: “Të gjitha afatet e përcaktuara në Kushtetutë, pra si kohëzgjatja maksimale prej gjashtëdhjetë (60) ditësh e përcaktuar në nenin 82 (1.3), ashtu edhe afati imperativ për përfundimin e procedurës më së largu tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual, i përcaktuar në nenin 86 (2), janë plotësisht në harmoni me njëri tjetrin dhe nuk kanë asnjë kundërtension. Kohëzgjatja maksimale prej gjashtëdhjetë (60) ditësh është një mundësi procedurale që i është lënë në dispozicion Kuvendit, por e cila duhet të shfrytëzohet gjithmonë deri në detyrimin e përcaktuar në nenin 86 (2), afat ky i cili në asnjë rrethanë nuk mund të tejkalohet. Në rast se Kuvendit i lejohet mundësia të shkelë këtë detyrim të qartë kushtetues, kjo do ta bënte këtë nen totalisht të pazbatueshëm dhe të pavlerë.”
59. Presidentja, në komentet e dorëzuara gjithashtu thekson se: “mandati i Presidentes aktuale përfundon më 4 prill 2026, atëherë sipas nenit 86(2) të Kushtetutës, afati i fundit për zgjedhjen e Presidentit të ri ka qenë data 5 mars 2026, duke argumentuar se në rast se do të lejohej vazhdimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit, Republika e Kosovës do të gjendje përball një krize të dyfishtë kushtetuese: nga njëra anë, një President i zgjedhur jashtë afatit të përcaktuar kushtetues dhe, nga ana tjetër, një Kuvend që ka tejkaluar kufijtë e kompetencave të tij kushtetuese. Pikërisht për të shmangur një situatë të tillë të pasigurisë kushtetuese, Kushtetuta ka paraparë mekanizmin e shpërndarjes së Kuvendit, si pasojë përfundimtare kur dështon zgjedhja e Presidentit.”
60. Tutje, Presidentja thekson se qëllimi i afatit përfundimtar të zgjedhjes së Presidentit të ri më së largu tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual siguron vazhdimësi të funksionimit të institucionit dhe tranzicionit efektiv ndërmjet mandateve, duke e ndërlidhur me praktikën e shumicën e shteteve demokratike me një rregullim të ngjashëm sikurse Shqipëria, Finlanda, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Letonia, Hungaria etj.
61. Presidentja po ashtu thekson se pretendimet për mundësinë e aplikueshmërisë së paragrafit 3 të nenit 90 janë plotësisht në kundërshtim me qëllimin e nenit 90 të Kushtetutës, duke argumentuar se i njëjti “[...] përcakton se posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj, [...] vetëm në rrethanat shtruese të nenit 90 Kushtetutës [...] Në asnjë rrethanë tjetër të parashikueshme, Kushtetuta nuk e parasheh ushtrimin e detyrës së

Presidentit nga Kryetari i Kuvendit. Aq më pak në rrethana plotësisht të parashikueshme, pra detyrimin kushtetues që Presidenti të zgjedhet tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit aktual”.

62. *Presidentja tutje thekson se: “në rastin konkret, nuk ekziston asnjëra nga rrethanat e përcaktuara në nenin 90 të Kushtetutës. Prandaj, është plotësisht kundërkushtetuese që ko dispozitë të shfrytëzohet për të inkurajuar dhe legjitimuar moszgjedhjen e Presidentit para kalimit të afatit përfundimtar të nenin 86 (2), nën arsyetimin se pozita nuk mbetet plotësisht vakante dhe mbahet me ushtrues detyre.”*
63. *Përkitazi me afatet e përcaktuara dhe të ndërlidhura me paragrafin 1.3 të nenit 82, paragrafin 6 të nenit 86 dhe paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës, Presidentja thekson se: “(i) neni 82 (1.3) i Kushtetutës përcakton një mundësi prej maksimalisht gjashtëdhjetë (60) ditësh për zgjedhjen e Presidentit, nga dita e fillimit të procedurës; (ii) nenet 82 (1.3) dhe 86 (6) të Kushtetutës kufizojnë kohëzgjatjen dhe në numër tentativat aktive të Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit; ndërkaq (iii) përgatitjet dhe tentativat domosdoshmërisht duhet të përfundojnë para skadimit të afatit imperativ përfundimtar të përcaktuar në nenin 86 (2).”*
64. *Presidentja më tej thekson se: “leximi i përbashkët i dispozitave kushtetuese lidhur me zgjedhjen e Presidentit (pra nenet 82 (1.3), 86 (2) dhe 86 (6) nënkupton që Kushtetuta kufizon periudhën kohore brenda të cilës duhet të zgjedhet Presidenti dhe gjithashtu numrin e raundeve të votimit për këtë qëllim. Në tërësinë e tyre, mund të zhvillohen deri në tri raunde votimi në kuadër të një periudhe kohore prej maksimalisht gjashtëdhjetë (60) ditësh, por që të dy rrethanat megjithatë kushtëzohen nga afati i përcaktuar në nenin 86 (2), pra nga kushti që e tërë procedura të përmbyllet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual. Pasoja e mosrespektimit të këtij afati do të ishte gjithnjë e njëjtë, pra shpërndarja e Kuvendit dhe caktimi i datës së zgjedhjeve.”*
65. *Së treti, përkitazi me pretendimin se dekreti nuk cenon parimin e ndarjes së pushteteve, Presidentja thekson se: “Dekreti është nxjerrë bazuar në kompetencat kushtetuese të Presidentes, si detyrim i qartë dhe i pashmangshëm në funksion të garantimit që institucionet kushtetuese të funksionojnë brenda kuadrit mirë të përcaktuar në Kushtetutën e Kosovës. Kjo nënkupton që Presidentja ka ushtruar funksionet e saj kushtetuese dhe nuk ka ndërhyrë në asnjë mënyrë në kompetencat e Kuvendit. Është Kuvendi ai që ka dështuar të zgjedh Presidentin brenda afateve kushtetuese, me pasojën e qartë kushtetuese të shpërndarjes së Kuvendit dhe mbajtjes së zgjedhjeve të reja.”*
66. *Tutje, Presidentja sqaron se: “Në rast të abstenimit nga nxjerrja e dekretit kushtetues, Presidentja do të dështonte të ushtronte një nga funksionet primare të saj të mirëcaktuara në Kushtetutë, dhe mos veprimi përmes shmangies së nxjerrjes së dekretit, do të vendoste Republikën e Kosovës në një situatë ku do të cenohej rendi kushtetues i shtetit, sepse periudha kohore prej gjashtëdhjetë (60) ditësh për të cilin parashtruesit pretendojnë që aplikohet edhe pas kalimit të afatit në nenin 86 (2), do të ishte vetëm një zvarritje procedure meqë Presidenti në asnjë rrethanë nuk do të mund të zgjedhej pas kalimit të afatit përfundimtar imperativ të përcaktuar në nenin 86 (2).”*
67. *Në këtë kuptim, Presidentja thekson se: “Dekreti nr.24/26 i Presidentes nuk ka krijuar situatë të re juridike, por ka formalizuar një pasojë që buron nga vetë Kushtetua, e që është shpërndarja e Kuvendit në raste kur Kuvendi dështon të përmbushë detyrimin e tij kushtetues për zgjedhjen e Presidentit të ri, të përcaktuar në nenin 65 (7) të Kushtetutës.”*

68. Së katërti, Presidentja specifikon se nuk ka pasur rrethana objektive apo të jashtëzakonshme të cilat do të pamundësonin zgjedhjen e presidentit të ri para skadimit të afatit përfundimtar, duke sqaruar se: (i) nuk ka pasur përfundim të parakohshëm të mandatit të Presidentes që do të arsyetonte mbështetjen në nenin 82 (1.3); dhe (ii) nuk kanë ekzistuar rrethana të tjera objektive që do ta pamundësonin zgjedhjen e Presidentit para afatit përfundimtar të nenit 86 (2).
69. Lidhur me këtë, Presidentja thekson se mandati i Presidentes aktuale ka qenë plotësisht i parashikueshëm, duke argumentuar se: *“Mbështetja në periudhën prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të përcaktuar në nenin 82 (1.3) të Kushtetutës mund të vinte në shprehje vetëm në situata kur përfundimit i mandatit të Presidentit është i paparishikueshëm, si në rast të dorëheqjes, pamundësisë për ushtrimin e detyrës apo rrethanave të tjera të papritura që krijojnë zbrazëti në këtë funksion kushtetues. [...] Prandaj, periudha maksimale prej gjashtëdhjetë (60) ditësh e përmendur në nenin 82 (1.3) nuk mund të interpretohet si një afat që zëvendëson apo tejkalon afatin përfundimtar të përcaktuar në nenin 86 (2) të Kushtetutës në rastet kur përfundimi i mandatit të Presidentit është i parashikueshëm.”*
70. Tutje, Presidentja sqaron se: *“Kushtetuta është shumë e qartë për rastet tejet të kufizuara në të cilat funksioni i Presidentit mund të ushtrohet nga ushtrues detyre. Neni 90 i Kushtetutës parasheh rrethanat e përkohshme për ushtrimin e kësaj detyre nga Kryetari i Kuvendit, përfshirë këtu paafhtësinë e përkohshme të përmbushjes së përgjegjësive të tij/saj. Prandaj, Kushtetuta e bën të qartë se ky është një mekanizëm përjashtimor dhe i përkohshëm, dhe jo një alternativë e zakonshme ndaj zgjedhjes së Presidentit për t’u dhënë komoditet partive politike. [...] “Për më tepër, një ushtrim i tillë i funksionit të Presidentit nga ushtruesi i detyrës do të krijonte një situatë në të cilën një institucion që buron nga shumica parlamentare do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në të tri pushtetet, duke cenuar balancën kushtetuese ndërmjet institucioneve. Një situatë e tillë do ta pamundësonte ushtrimin efektiv të rolit të Presidentit si një filtër institucional në vendimmarrje të rëndësishme që lidhen me politikën e jashtme, mbrojtjen e sigurinë, sistemin e drejtësisë dhe funksionimin e përgjithshëm të institucioneve kushtetuese.”*
71. Në këtë drejtim, Presidentja thekson se nuk kanë ekzistuar rrethana të tjera objektive që do ta pamundësonin zgjedhjen e Presidentit para afatit përfundimtar të paragrafit 2 të nenit 86 të Kushtetutës, për faktin se: *“Pas konstituimit të Legjislaturës së Dhjetë më 11 shkurt 2026, deputetët e Kuvendit kanë pasur në dispozicion plot njëzet e tri (23) ditë për të zhvilluar dhe përmbyllur procedurën e zgjedhjes së Presidentit brenda afatit kushtetues. [...] “Përderisa deputetët të cilët kanë parashtruar rastin KO74/26, kërkojnë gjashtëdhjetë (60) ditë shtesë për zgjedhjen e Presidentit të ri, të njëjtit nuk e kanë shfrytëzuar as edhe një ditë të plotë nga gjithsej njëzet e tri ditët të cilat i kanë pasur në dispozicion. Më saktësisht, nga 552 orë të cilat ata i kanë pasur në dispozicion, ata kanë zgjedhur të shfrytëzojnë vetëm rreth një orë për të tentuar të përmbushin njërin nga detyrimet e tyre kryesore kushtetuese.”*
72. Për më tepër, Presidentja thekson se: *“[...] dështimi i Kuvendit për të arritur konsensusin e nevojshëm politik për zgjedhjen e Presidentit nuk mund të konsiderohet si një rrethanë objektive që do të justifikonte tejkalimin e afatit kushtetues. Pamundësia për të arritur kompromis politik nuk përbën pengesë kushtetuese, por përkundrazi përfaqëson dështimin e vetë Kuvendit për të ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë që i janë besuar nga Kushtetuta. Pezullimi i afatit në rast të ekzistimit të forcës madhore do të ishte i kuptueshëm, por jo pamundësia e gjetjes së kompromisit dhe konsensusit politik.”*

73. Gjithashtu, Presidentja thekson se në rastin konkret: *“Republika e Kosovës nuk ka qenë në gjendje të jashtëzakonshme dhe nuk ka pasur rrezik ndaj rendit kushtetues apo sigurisë publike që do të mund të justifikonte devijimin nga obligimet dhe afatet e qarta kushtetuese. Rrjedhimisht, moszgjedhja e Presidentit brenda afatit kushtetues përfundimtar të përcaktuar në nenin 86.2 nuk ka qenë rezultat i ndonjë pengese objektive, por i mungesës së vullnetit politik për të arritur një marrëveshje në Kuvend. Kështu, nuk ekziston asnjë bazë kushtetuese që do të lejonte vazhdimin e procesit të zgjedhjes së Presidentit pas kalimit të afatit përfundimtar të përcaktuar në nenin 86.2 të Kushtetutës.”*
74. Në vijim, Presidentja sqaron se: *“Kushtetuta jonë, e interpretuar edhe nga praktika e Gjykatës Kushtetuese, përcakton që dështimi në zgjedhjen e Presidentit dhe Qeverisë, janë momente që shkaktojnë shpërndarjen e Kuvendit. Andaj, krahasimi i procedurës së zgjedhjes së Presidentit të vendit me procedurat e zgjedhjes së udhëheqësve të institucioneve tjera, shumica e të cilëve madje zgjedhën përmes konkurseve publike, në vetvete paraqet mosnjohje esenciale të vet peshës dhe përgjegjësisë që kanë deputetët lidhur me zgjedhjen e Presidentit.”*
75. Si përfundim, Presidentja thekson se në rastin konkret *“[...] nuk kemi të bëjmë me një paqartësi kushtetuese, por me një normë të qartë dhe detyruese të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht nenin 86 (2) i cili qartazi përcakton afatin përfundimtar dhe imperativ për zgjedhjen e Presidentit të Republikës” [...] “Në rastin konkret, ky afat ka kaluar pa u përmbushur detyrimi kushtetues i Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të ri, duke aktivizuar kështu mekanizmin e shpërndarjes së Kuvendit nga ana e Presidentes, sic tashmë është konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese në rastin KO72/20 [Aktgjykimi nr. KO72/20, paragrafët 384/386].”*
76. Rrjedhimisht, Presidentja, kërkon nga Gjykata që: *“[...] të konfirmojë se respektimi i afateve kushtetuese, në rastin konkret respektimi i afatit përfundimtar dhe imperativ të përcaktuar në nenin 86 (2) të Kushtetutës, është detyrim kushtetues, i domosdoshëm për ruajtjen e stabilitetit institucional, funksionimin demokratik të shtetit dhe besimin e qytetarëve në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.”*

Komentet e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës

77. Më 12 mars 2026, deputetët e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Grupi Parlamentar i LDK-së) dorëzuan në Gjykatë komentet ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesave KO72/26 dhe KO74/26.
78. Fillimisht, Grupi Parlamentar i LDK-së thekson se: *“Dekreti i Presidentes është në përputhje të plotë me Kushtetutën, pasi rrjedh nga interpretimi sistematik, teologjik dhe funksional i dispozitave kushtetuese dhe synon mbrojtjen e rendit kushtetues, funksionimin demokratik të institucioneve dhe stabilitetin institucional të shtetit.”*
79. Tutje, Grupi Parlamentar i LDK-së, përkritazi me aplikimin e paragrafit 2 të nenit 86 të Kushtetutës sqaron se: *“Kjo dispozitë kushtetuese aplikohet në rastet kur shteti e ka Presidentin duke e kryer mandatin e vet kushtetues. Kjo dispozitë krijon një detyrim të drejtpërdrejtë, të qartë dhe imperativ për Kuvendin e Republikës së Kosovës (Kuvendi) që ta zgjedhë Presidentin e Republikës së Kosovës (Presidenti) brenda këtij afati kushtetues.”*, duke theksuar se në rrethanat e rastit konkret *“Kuvendi ka dështuar ta përmbush këtë detyrim kushtetues brenda afatit të përcaktuar me Kushtetutë.”*

80. Në këtë drejtim Grupi Parlamentar i LDK-së, argumenton se: *“Në rastet kur Kuvendi dështon të zgjedh Presidentin brenda këtij afati final kushtetues, nuk ka asnjë rrugë tjetër, përveç që Kuvendi i Republikës të shpërndahet sepse nuk ka arritur që ta kryej detyrimin kushtetues për të zgjedhur Presidentin e Republikës. Prandaj, Presidentja e Republikës ka vepruar në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës në momentin që ka nxjerr dekretin me datë 06 mars 2026. Ndryshe, Presidentja do të bënte shkelje kushtetuese dhe nuk do të ushtronte rolin e saj që të siguronte funksionimin demokratik të institucioneve.”*
81. Grupi Parlamentar i LDK-së, lidhur me paragrafin 2 të nenit 86 specifikon se: (i) në rastin konkret, mandati i Presidentes aktuale skadon më 4 prill 2026; (ii) kushtetuta nuk përcakton afatin e fillimit të zgjedhjes, duke i lënë hapësirë Kuvendit që këtë proces ta filloj muaj para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual; (iii) Kuvendi ka dështuar të sigurojë konsensusin e nevojshëm politik për zgjedhjen e Presidentit të ri; (iv) ky paragraf përmban afatin final kushtetues të zgjedhjes së Presidentit’ (v) formulimi i këtij paragrafi përmban normë urdhëruese duke vënë theksin te fjala *“duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual”*; (vi) mos respektimi i këtij afati krijon një situatë të papajtueshme me rendin kushtetues, dhe se (vii) dështimi për të zgjedhur Presidentin e Republikës brenda këtij afati, i hap rrugë shpërndarjes së Kuvendin dhe mbajtjes së zgjedhjeve të reja.
82. Për më tepër, Grupi Parlamentar i LDK-së, përkitazi me rolin e deputetëve në zgjedhjen e Presidentit theksojnë se: *“Ky është mekanizmi i vetëm kushtetues përmes të cilit deputetët e Kuvendit e shprehin vullnetin e tyre, të vetëdijshëm që mos zgjedhja e Presidentit brenda afatit kushtetues, prodhon pasojë-humbjen e mandatit. Ndryshe nuk ka asnjë mekanizëm tjetër detyrues ndaj deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse ashtu siç përcaktohet me nenin 70 pika 1 “Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.”*
83. Tutje, Grupi Parlamentar i LDK-së, përkitazi me nenin 90 të Kushtetutës, thekson se ky nen *“[...] nuk ka përcaktuar në asnjë pikë mbetjen vakante të pozitës së Presidentit për shkak të dështimit të zgjedhjes së Presidentit të ri”* duke argumentuar se afatin përkitazi me zgjedhjen veçse e ka përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 86.
84. Përkitazi me aplikimin e nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës, Grupi Parlamentar i LDK-së vlerëson se i njëjti : (i) përcakton që Kuvendi shpërndahet nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës; ndërkaq (ii) aplikohet në raste kur vendi mbetet pa President, rrjedhimisht kur pozita e Presidentit mbetet me ushtrues të detyrës së Presidentit.
85. Për më tepër, Grupi Parlamentar i LDK-së, argumenton se Kushtetuta përmban rrjedhë logjike procedurale duke theksuar se pas dështimit të zgjedhjes së Presidentit sipas afatit të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës dhe shpërndarjes së Kuvendit, vendi mbetet me ushtrues detyre të Presidentit, të cilin post nuk mund ta ushtrojë më gjatë se gjashtë (6) muaj. Organizimi i zgjedhjeve të parakohshme duhet të bëhet brenda 45 ditëve duke i dhënë afatin prej gjashtëdhjetë (60) ditësh legjislaturës së re, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të vendit, duke theksuar se afati i përcaktuar në paragrafin 1 (3) të nenit 82 të Kushtetutës përcakton pasojën kushtetuese të dështimit të zgjedhjes së Presidentit brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga fillimi i procedurës së zgjedhjes, dhe si e tillë nuk mund të përdoret për të legjitimuar vazhdimin e një situatë që tashmë ka hyrë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht mosrespektimit të afatit të paragrafit 2 të nenit 86 të Kushtetutës.

86. Grupi Parlamentar i LDK-së, thekson se: *“Moszgjedhja e Presidentit brenda afatit kushtetues krijon rrezik real për krizë institucionale, vakum kushtetues dhe destabilizim të rendit institucional e kushtetues. Në këto rrethana, shpërndarja e Kuvendit dhe rikthimi i mandateve të qytetarët përmes zgjedhjeve të parakohshme përbën mekanizëm demokratik dhe kushtetues për rikthimin e legjitimitetit institucional dhe kushtetues të të gjitha institucionet.”*
87. Gjithashtu, Grupi Parlamentar i LDK-së përkitazi me proporcionalitetin e Dekretit të kontestuar thekson se i njëjti: (i) është në përputhje me Kushtetutën; (ii) ndjek një qëllim legjitim, përkatësisht zgjidhjen e një krize institucionale; (iii) ishte i domosdoshëm sepse mungonte një mjet tjetër efektiv për tejkalimin e bllokadës së krijuar; dhe (iv) nuk cenon rendin demokratik, përkundrazi rikthen vendimmarrjen të qytetarët përmes zgjedhjeve të parakohshme.
88. Si përfundim, Grupi Parlamentar i LDK-së, rithekson se *“[...] Kuvendi kishte detyrim kushtetues imperativ që ta zgjedhte Presidenti jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual. Mosrespektimi i këtij afati krijon në situatë të papajtueshme me Kushtetutën, gjë që rrezikon seriozisht që vendi të mbetet pa President për një kohë edhe më të gjatë se gjashtë (6) muaj. Neni 82 paragrafi 1(3) i Kushtetutës nuk mund të interpretohet në atë mënyrë që të neutralizojë nenin 86 paragrafi 2, të shpërblejë shkeljen e Kushtetutës ose të prodhojë bllokadë institucionale.”* Duke theksuar se në rastin konkret Presidentja ka vepruar në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësit e saj për të mbrojtur funksionin kushtetues dhe demokratik të institucioneve dhe stabilitetin e vendit, me propozimin që Gjykata të konstatoj se Dekreti i kontestuar është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komentet e Grupit Parlamentar Multietnik

89. Më 12 mars 2026, deputetët e Grupit Parlamentar Multietnik (në tekstin e mëtejshëm: Grupi Parlamentar Multietnik) dorëzuan në Gjykatë komentet ndaj pretendimeve të parashtruesve të kërkesave KO72/26 dhe KO74/26.
90. Fillimisht, Grupi Parlamentar Multietnik theksoi se të njëjtit ishin të pranishëm the morën pjesë në seancën e 5 marsit 2026 për votimin e zgjedhjes së Presidentit/es të Republikës.
91. Në këtë drejtim, Grupi Parlamentar Multietnik, përkitazi me pretendimet për tejkalim të kompetencave në shpërndarjen e Kuvendit, thekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës është ndërtuar mbi modelin e Republikës parlamentare, ku shpërndarja e Kuvendit mund të ndodhë vetëm në rrethana të përcaktuara kushtetuese, e cila ndryshe njihet si *“shpërndarje e kushtëzuar”*.
92. Prandaj, Grupi Parlamentar Multietnik, konsideron se: *“Veprimi i Presidentes për shpërndarjen e Kuvendit tejkalon kompetencat e përcaktuara nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe bie ndesh me rendin juridik të vendit. Një vendim i tillë shpie në një Kuvend jofunksional dhe, rrjedhimisht, në një qeveri në detyrë brenda 21 ditëve nga votimi i saj në Kuvend, edhe pse qeveria dhe Kuvendi disponojnë shumicën parlamentare të nevojshme për funksionimin normal.”*
93. Më tej, Grupi Parlamentar Multietnik, thekson se: *Në rastin konkret, veprimi i Presidentes për shpërndarjen e Kuvendit tejkalon kompetencat kushtetuese, pasi ndërhyr drejtpërdrejt në funksionimin e parlamentit dhe i jep përparësi vendimmarrjes presidenciale mbi vullnetin popullor të shprehur përmes konstituimit*

të Kushtetutës. Siç nënvizohet nga një seri opinionesh të Komisionit të Venecias, roli i Presidentit në sistemet parlamentare është i rëndësishëm vetëm në masën që ai mbetet garant procedural dhe nuk zëvendëson qendrën e përgjegjësisë, e cila, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mbetet tek parlamenti dhe qeveria.” Në mbështetje të këtyre argumenteve, të njëjtit i referohen opinioneve të Komisionit të Venecias për Republikën e Moldavisë, përkatësisht [Opinionit nr. CDL-AD\(2019\)012](#); [Opinionit nr. CDL-AD\(2017\)014](#) dhe [Opinionit CDL-AD\(2019\)027](#).

94. Si përfundim, Grupi Parlamentar Multietnik kërkon nga Gjykata të shfuqizojë Dekretin e kontestuar, pasi konsiderojnë se: “*Dekreti për shpërndarjen e Kuvendit, prek barazinë mes palëve, dhe mandatin e deputetëve të komuniteteve pakicë, duke ia mbivendosur normën kushtetuese veprimin diskrecional të pabazuar të Presidentes.*”

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 4

[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

“1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.

[...]

Neni 7

[Vlerat]

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”

Neni 16

[Epërsia e Kushtetutës]

“1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.

2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetua.

3. Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare.

4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.”

Neni 66
[Zgjedhja dhe Mandati]

“1. Kuvendi i Kosovës zgjedhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.

2. Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit, kurse në raste të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës e thërret seancën e parë të Kuvendit. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mblidhet pa pjesëmarrjen e Presidentit.

4. Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës, dhe vetëm për aq sa zgjat Gjendja e Jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me këtë Kushtetutë.

5. Kushtet, zonat dhe procedurat zgjedhore, rregullohen me ligj.”

Neni 74
[Ushtrimi i Funkcionit]

“Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”

Neni 82
[Shpërndarja e Kuvendit]

“1. Kuvendi shpërndahet në këto raste:

(1) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;

(2) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;

(3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.

2. Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë.”

Neni 84
[Kompetencat e Presidentit]

“ Presidenti i Republikës së Kosovës:

[...]

(2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;

[...]”

Neni 86
[Zgjedhja e Presidentit]

“1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë.

2. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.
3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidatë për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidatë për President të Republikës së Kosovës.
4. Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
5. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.
6. Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjedhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.”

Neni 87
[Mandati dhe Betimi]

- “1. Presidenti i Republikës së Kosovës fillon mandatin pasi të ketë dhënë betimin para Kuvendit të Kosovës. Teksti i betimit rregullohet me ligjin.
2. Mandati i Presidentit është pesë (5) vjet.
3. Pas përfundimit të mandatit të parë, Presidenti mund të rizgjedhet vetëm edhe një herë.”

LIGJI NR.03/L-094 PËR
PRESIDENTIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 4

- “1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi me votim të fshehtë, sipas procedurës së paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
2. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.
3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës, që plotëson kriteret e parapara në nenin 3 të këtij ligji, mund të nominohet si kandidat për President të Republikës së Kosovës, nëse ai/ajo siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidat për President të Republikës së Kosovës.”

RREGULLORE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 106

- “1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe me dispozitat e Ligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës.
2. Komisioni përkatës për Legjislacion shqyrton nëse kandidatët e nominuar për president i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës dhe ia paraqet raportin seancës plenare.
3. Për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, gjatë tri votimeve, duhet të ketë më së paku dy (2) kandidatë.
4. Në seancë plenare formohet Komisioni zgjedhor për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i përbërë nga një deputet prej secilit grup parlamentar.

5. Për të qenë i vlefshëm votimi i parë dhe votimi i dytë, duhet të marrin pjesë në votim të paktën 80 deputetë, ndërsa në votimin e tretë duhet të marrin pjesë të paktën 61 deputetë.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

95. Në mënyrë që të vendos lidhur me kërkesat e parashtruesve të kërkesës, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

96. Së pari, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton se:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”

97. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit 2 (1), të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë si në vijim:

“2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën; [...].”

98. Në vijim, Gjykata u referohet edhe neneve 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit që parashohin:

Neni 29 Saktësimi i kërkesës

1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.

2. Kërkesa e ngritur kundër Dekretit të kontestuar sipas nenit 113, paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.

3. Kërkesa do të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar.

Neni 30 Afatet

Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të Dekretit të kontestuar.

99. Gjykata po ashtu i referohet edhe rregullit 65 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.2 (1) dhe (2) të Kushtetutës dhe neneve 29 dhe 30 të Ligjit] të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nënparagrafët (1) dhe (2) të paragrafit (2) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 29 (Saktësimi i kërkesës) dhe 30 (Afatet) të Ligjit.

(2) Kur parashtron një kërkesë në pajtim me paragrafin (2) të nenit 113 të Kushtetutës, pala e autorizuar duhet të tregojë, ndër të tjera, nëse përmbajtja e plotë ose pjesë të caktuara të Dekretit të kontestuar, konsiderohen të jenë në mospërputhshmëri me Kushtetutën.

(3) Pala e autorizuar duhet të paraqesë në kërkesë kundërshtimet lidhur me kushtetutshmërinë e Dekretit të kontestuar.

(4) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të parashtrohet brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të Dekretit të kontestuar.”

100. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë: (i) nëse kërkesa është parashtruar nga një palë e autorizuar, siç është përcaktuar në nënparagrafin 1 të paragrafit 2 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 29 të Ligjit; (ii) natyrën e Dekretit të kontestuar; (iii) saktësimin e kërkesës, siç kërkohet përmes paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 29 të Ligjit dhe paragrafëve 2 dhe 3 të Rregullit 65 të Rregullores së Punës; dhe (iv) nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të Dekretit të kontestuar, siç është përcaktuar në nenin 30 të Ligjit dhe paragrafin (4) të Rregullit 65 të Rregullores së punës.

(i) Lidhur me Palën e Autorizuar

101. Kuvendi dhe Qeveria, bazuar në nenin 113, paragrafin 2, nënparagrafin 1 të Kushtetutës janë të autorizuar që para Gjykatës të ngrenë çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën, të: (i) ligjeve; (ii) dekreteve të Presidentit; (iii) dekreteve të Kryeministrit; dhe (iv) rregulloreve të Qeverisë. Neni 29 i Ligjit, saktëson që Kuvendi dhe Qeveria janë palë të autorizuar para Gjykatës, përkatësisht nëse kërkesat përkatëse janë parashtruar nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit dhe Qeveria. E njëjta kërkesë është e specifikuar në paragrafin 1 të rregullit 65 të Rregullores së punës.

102. Në rrethanat e rastit konkret Gjykata vëren se kërkesa e parë ishte parashtruar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, në emër të Qeverisë, përderisa kërkesa e dytë është parashtruar nga tridhjetë e një (31) deputetë të Kuvendit. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se kërkesat u parashtruan nga Qeveria dhe 31 deputetë të Kuvendit, në pajtim me nenin 113, paragrafi 2, nënparagrafin 1 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 29, paragrafi 1 të Ligjit. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që parashtruesit e kërkesave janë palë të autorizuar para Gjykatës.

(ii) Lidhur me Dekretin e kontestuar

103. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se bazuar në nenin 113, paragrafin 2, nënparagrafin 1 të Kushtetutës, Kuvendi, përkatësisht një e katërta (1/4) e deputetëve të tij dhe Qeveria mund të kontestojnë përputhshmërinë e “*ligjeve*”, “*dekreteve të Presidentit*”, “*dekreteve të Kryeministrit*”, dhe “*rregulloreve të Qeverisë*” me Kushtetutën.

104. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesave, specifikuan Aktin, kushtetutshmërinë e të cilit e kontestojnë para Gjykatës, përkatësisht, Dekretin [nr. 24/2026] e 6 marsit 2026, të Presidentes sipas të cilit “*Shpërndahet Legjislatura e Dhjetë (X) e Kuvendit të Republikës së Kosovës*”. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Akti i kontestuar i plotëson kushtet për të qenë objekt shqyrtimi nga Gjykata ashtu siç specifikohet në nenin 113, paragrafin 2, nënparagrafin 1 të Kushtetutës.

(iii) Lidhur me saktësimin e kërkesës

105. Gjykata rikujton që neni 29 i Ligjit dhe rregulli 65 i Rregullores së punës, përcaktojnë që: (i) kërkesa e parashtruar në bazë të nenit 113.2 (1) të Kushtetutës, duhet të specifikojë nëse i tërë Akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij Akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën; dhe (ii) të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së Dekretit të kontestuar.
106. Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesave, (i) Aktin e kontestuar, përkatësisht Dekretin [nr. 24/2026] e 6 marsit 2026, të Presidentes së Republikës së Kosovës, e kundërshtojnë në tërësinë e tij, dhe të njëjtit (ii) parashtruan kundërshtimet e tyre lidhur me kushtetutshmërinë e Dekretit të kontestuar ashtu siç specifikohet me nenin 113, paragrafin 2, nënparagrafin 1 të Kushtetutës, nenin 29, paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit, dhe rregullin 65, paragrafët (2) dhe (3) të Rregullores së punës.

(iv) Lidhur me afatin

107. Gjykata rikujton që neni 30 i Ligjit dhe rregulli 65 i Rregullores së punës, përcaktojnë që kërkesa e parashtruar bazuar në nenin 113, paragrafin 2, nënparagrafin 1 të Kushtetutës, duhet të dorëzohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të Dekretit të kontestuar.
108. Në vijim të kësaj, Gjykata vëren se Dekreti i kontestuar i Presidentes është nxjerrë më 6 mars 2026, ndërsa parashtruesit e kërkesave të njëjtin e kanë kontestuar në Gjykatë më 7 mars 2026, përkatësisht më 9 mars 2026. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesat e parashtruesve u parashtruan brenda afatit kohor të përcaktuar me nenin 30 të Ligjit dhe paragrafit 4 të rregullit 65 të Rregullores së punës.

Konkluzion lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

109. Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesave: (i) janë palë të autorizuar para Gjykatës; (ii) kontestojnë Dekretin [nr. 24/2026] të 6 marsit 2026; (iii) kanë specifikuar se Aktin e kontestuar e kontestojnë në tërësinë e tij; (iv) kanë paraqitur kundërshtimet e tyre lidhur me kushtetutshmërinë e Dekretit të kontestuar; dhe, (v) kanë dorëzuar kërkesat e tyre brenda afatit të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës.
110. Rrjedhimisht, Gjykata e shpallë kërkesat e pranueshme dhe në vijim do të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

I. Hyrja

111. Gjykata fillimisht rikujton që më 9 shkurt 2025 u mbajtën zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, më 15 prill 2025 filloi Seanca Konstituive e Kuvendit, e cila u përmbyll pas nxjerrjes së tri (3) Aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese [shih, Aktgjykimet KO124/25, KO193/25 dhe KO196/25, dhe KO265/25]. Si rezultat i dështimit për zgjedhjen e Qeverisë nga Kuvendi, në seancën e 19 nëntorit 2025, dhe bazuar në Dekretin e Presidentes [Nr. 209/2025] për Shpërndarjen e Legjislaturës së IX-të, Presidentja përmes Dekretit [nr. 210/2025] të 20 nëntorit 2025 shpalli zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që u caktuan për datën 28 dhjetor 2025. Gjykata rikujton se si rezultat i certifikimit të zgjedhjeve të 28 dhjetorit 2025, më 11 shkurt 2026 u mbajt Seanca Konstituive e Kuvendit, me ç'rast përmes zgjedhjes së Kryetares së Kuvendit dhe nënkryetarëve,

Legjislatura e X-të e Kuvendit u shpall e konstituuar. Po të njëjtën ditë, Kuvendi bazuar në nenin 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës vijoi me zgjedhjen e Qeverisë. Në vijim, duke marrë për bazë përcaktimet e nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës dhe faktit që Presidentes aktuale i përfundon mandati më 4 prill 2026, Kuvendi, më 5 mars 2026 bazuar në kërkesën e dyzet e dy (42) deputetëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, mbajti seancën e jashtëzakonshme me të vetmen pikë të rendit të ditës “Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës”. Në këtë seancë të jashtëzakonshme për zgjedhjen e Presidentit, të thirrur nga Kryetarja e Kuvendit u propozuan dy (2) kandidatë për Presidentë. Pasi që u konstatua se në sallë ishin prezent gjashtëdhjetë e gjashtë (66) deputetë, si rezultat i mungesës së prezencës së 2/3 të deputetëve, Kryetarja e Kuvendit ndërpreu seancën e jashtëzakonshme. Më 6 mars 2026, Presidentja, nxori Dekretin [nr.24/26] sipas të cilit specifikohet se: “Shpërndahet Legjislatura e Dhjetë (X) të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, si rezultat i kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës.

112. Më 7 dhe 9 mars 2026, parashtruesit e kërkesave të bashkuara KO72/26 dhe KO74/26 kërkuan vlerësimin e Dekretit [nr. 24/2026] të Presidentes të Republikës së Kosovës, të 6 marsit 2026 për të cilin pretendojnë se nuk është në pajtueshmëri me paragrafët 1 dhe 3 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës], nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit], paragrafin 2 të nenit 84 [Kompetencat e Presidentit] dhe paragrafin 2 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës.
113. Më 9 mars 2026, Gjykata: (i) vendosi të caktojë sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës KO72/26 masën e përkohshme me të cilën ndalohet çdo veprim i Presidentes së Republikës Kosovës në lidhje me Dekretin [nr. 24/2026] e 6 marsit 2026, dhe (ii) *ex officio* vendosi që të ndalojë çdo veprim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me efekt nga 9 marsi 2026 në kohëzgjatje deri më 31 mars 2026.
114. Gjykata rikujton se thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesave përkitazi me kushtetutshmërinë e Dekretit të kontestuar ndërlidhet me mosshkrimin e afatit gjashtëdhjetë (60) ditor nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes së Presidentit, i përcaktuar me nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës. Pretendimet e parashtruesve të kërkesave mbështeten nga Grupi Parlamentar Multietnik, ndërkaq kundërgargumentohen nga Presidentja dhe Grupi Parlamentar i LDK-së, me arsyetimin se afati për zgjedhjen e Presidentit është i përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës, përmes së cilit përcaktohet se zgjedhja e Presidentit duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual, dhe se kalimi i këtij afati është kundërkushtetues.
115. Gjykata rikujton se në rrethanat e rastit konkret, objekt i vlerësimit nga Gjykata, përbëjnë dy çështje të ndërlidhura, përkatësisht (i) interpretimi i dispozitave kushtetuese lidhur me afatet për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, përkatësisht afatet e përcaktuara me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës dhe nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës, përfshirë pasojat kushtetuese të mosrespektimit të këtyre afateve si dhe (ii) vlerësimin e dispozitave kushtetuese që ndërlidhen me detyrimin kushtetues për garantimin e vazhdimësisë së funksionimit të institucioneve kushtetuese në kontekst të procedurës së zgjedhjes së Presidentit.
116. Në funksion të vlerësimit të objektit të kërkesës, në vijim, Gjykata do të shtjellojë: (i) parimet e përgjithshme kushtetuese, që përfshijnë parimet kushtetuese në kontekst të (a) dispozitave kushtetuese që përcaktojnë rolin e Kuvendit dhe Presidentit në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, si dhe (b) procedurën e zgjedhjes së Presidentit dhe shpërndarjes së Kuvendit; (ii) përmbajtjen e dokumenteve përgatitore për hartimin e Kushtetutës përkitazi me zgjedhjen e Presidentit dhe shpërndarjen e Kuvendit, dhe (iii)

analizën krahasimtare të Kushtetutave të vendeve tjera lidhur me zgjedhjen e Presidentit dhe shpërndarjen e Kuvendit; (iv) interpretimin e dispozitave kushtetuese që ndërlidhen me afatet kushtetuese përkitazi me procedurën e zgjedhjes së Presidentit dhe shpërndarjen e Kuvendit; dhe në fund do të ofrojë (v) vlerësimin e saj lidhur me procedurën e zgjedhjes së Presidentit në rrethanat e rastit konkret dhe efektet e Dekretit të kontestuar të Presidentes ndërlidhur me procedurën e zgjedhjes së Presidentit të ri.

II. Parimet e përgjithshme

A. Parimet e përgjithshme kushtetuese

117. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë shteti i Republikës së Kosovës. Këto parime dhe vlera mishërojnë dhe pasqyrojnë frymën e Kushtetutës, e cila është e transpozuar në secilën normë të saj. Si e tillë, Kushtetuta dhe secila normë e saj duhet të interpretohen në ndërvaresi me njëra tjetrën dhe jo të izoluar nga njëra tjetra, dhe gjithnjë duke pasur parasysh parimet dhe vlerat e saj. Asnjë normë e Kushtetutës nuk mund të interpretohet në mënyrë të ndarë dhe të izoluar nga parimet dhe vlerat e proklamuar në Kushtetutë, përfshirë Preambulën e saj. Asnjë normë kushtetuese nuk mund të nxirret jashtë kontekstit dhe të interpretohet në mënyrë të shkëputur nga pjesa tjetër e Kushtetutës. Kjo për faktin se Kushtetuta ka një kohezion të brendshëm sipas të cilit gjithsecila pjesë ka një ndërlidhje me pjesët e tjera të saj (shih, rastin e Gjykatës KO72/20, parashtues *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 qershorit 2020, paragrafi 346).
118. Në kuptim të dispozitave themelore kushtetuese, Gjykata thekson se neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i Kushtetutës përcakton formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushtetit, ku mes tjerash saktëson që Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë, parime këto sipas të cilave, (i) Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ; (ii) Presidenti është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën dhe duke përfaqësuar unitetin e popullit sipas të njëjtës; (iii) Qeveria është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar; (iv) pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat; dhe (v) Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës (shih, rastin KO124/25, parashtues *Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 26 qershorit 2025, paragrafi 101).
119. Neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës, saktëson që rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër të tjera, bazohet në parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, pluralizmit dhe ndarjes së pushtetit shtetëror dhe barazisë gjinore.
120. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është burimi i autoritetit të çdo pushteti qeverisës dhe ajo përcakton kufijtë e ushtrimit të këtij autoriteti (shih, rastin KO124/25, cituar më lartë, paragrafi 103).
121. Kësisoj, dhe në kuptim të funksionimit efektiv të institucioneve shtetërore, Gjykata ka theksuar rëndësinë e interpretimit të Kushtetutës përkitazi me themelimin e organeve kushtetuese, duke vlerësuar se përderisa funksionimi demokratik i institucioneve shtetërore është përgjegjësi parësore e secilit person i cili është i mveshur me autorizime

publike, të gjitha veprimet që ndërmerren nga personat e mveshur me fuqi ose autorizim publik duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për shtetin, duke mundësuar që ai të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar (shih, në lidhje me këtë rastin e Gjykatës KO124/25, cituar më lart, paragrafi 111).

122. Të gjitha pushtetet pa përjashtim, qofshin ato pjesë të trekëndëshit klasik të ndarjes së pushteteve, qofshin ato pjesë tjetër e rëndësishme e strukturës së shtetit, kanë detyrim kushtetues që të bashkëpunojnë me njëra tjetrën në të mirën e përgjithshme publike dhe në interesin më të mirë të të gjithë shtetasve të Republikës së Kosovës. Të gjitha këto pushtete kanë për obligim që të kryejnë detyrat e tyre publike me qëllim të jetësimit të vlerave dhe parimeve mbi të cilat është ndërtuar të funksionojë Republika e Kosovës. Në këtë aspekt, bashkëpunimi në mes të institucioneve kushtetuese/publike paraqet detyrim kushtetues dhe besnikëri ndaj betimit formal e publik me rastin e marrjes së përgjegjësisë kushtetuese nga secili bartës i funksionit përkatës publik (shih, rastin KO124/25, cituar më lart, paragrafi 118).
123. Për qëllime të interpretimit të nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82 dhe paragrafit 2 të nenit 86 të Kushtetutës, Gjykata konsideron të nevojshme që fillimisht të analizohen dy çështje themelore vijuese: (i) roli i Kuvendit në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës; dhe (ii) roli i Presidentit në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës. Përkritazi me këtë analizë, Gjykata do t'iu referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në Kushtetutë dhe të reflektuara në praktikën e saj gjyqësore të deritanishme, duke marrë parasysh edhe rrethanat relevante të rastit konkret.

Kuvendi në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës

124. Gjykata në rastet KO72/20 dhe KO124/25 ka theksuar se sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur të popullit, në pajtim me Kushtetutën. Mënyrë tjetër e ushtrimit të sovranitetit nga populli janë referendumet ose format e tjera të pajtueshme me Kushtetutën (shih, nenin 2 të Kushtetutës).
125. Kuvendi si institucion ligjvënës bazuar në paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës, zgjedhet me mandat katër (4) vjeçar. Pas përfundimit të rregullt të mandatit të Kuvendit, vendi shkon automatikisht në zgjedhje. Thënë këtë, qëllimi i një legjislature bazuar në Kushtetutë, është përfundimi i mandatit 4 (katër) vjeçar të saj. Në zgjedhje të reja, populli voton dhe zgjedh legjislaturën e re, me bindjen që ajo legjislaturë do t'i përfaqësojë për katër (4) vitet e tjera të radhës. Kjo paraqet ciklin e rregullt të zgjedhjes së përfaqësuesve të popullit në Kuvend. Përkundër këtij cikli të rregullt të demokracisë përfaqësuese, mandati i Kuvendit mund të mbarojë para përfundimit të mandatit të rregullt katër (4) vjeçar, vetëm sipas rregullimit të përcaktuar përmes nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës, ku specifikisht përcaktohen 3 (tri) situata të shpërndarjes së detyrueshme të Kuvendit dhe, një (1) situatë e mundshme e shpërndarjes së Kuvendit. Përjashtimisht, bazuar në paragrafin 4 të nenit 66 të Kushtetutës, mandati i Kuvendit mund të vazhdohet edhe përtej mandatit të rregullt kushtetues katër (4) vjeçar, në rrethana të Gjendjes së Jashtëzakonshme (shih, rastin KO124/25, cituar më lart, paragrafi 117 dhe KO72/20, cituar më lart, paragrafi 350).
126. Në një demokraci parlamentare, Kuvendi është organi më i lartë drejtues i mveshur me një shumëllojshmëri të kompetencave, që në të njëjtën kohë i nënshtrohet parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit ndërmjet tyre. Përveç Kushtetutës dhe detyrimit për të ushtruar pushtetin legjislativ në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi nuk i

nënshtrohet asnjë pushteti tjetër, ndërsa deputetët si përfaqësues të popullit nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.

Presidenti në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës

127. Gjykata fillimisht thekson që njëra ndër kompetencat thelbësore të Kuvendit, është edhe kompetenca për të zgjedhur Presidentin e Republikës së Kosovës.
128. Presidenti, si kreu i shtetit, *inter alia*, përfaqëson unitetin e popullit dhe është garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës. (shih, nenet 4 dhe 83 të Kushtetutës).
129. Presidenti ka një mori të kompetencave të cilat janë të përcaktuara specifikisht në Kushtetutë. Gjykata veçse ka theksuar se, përveç kompetencave të Presidentit të përcaktuara me nenin 84 të Kushtetutës, “*ekziston edhe një numër i madh referencash për Presidentin në Kushtetutë*” dhe se “*pushteti, funksionet, detyrat dhe kompetencat*” e Presidentit janë të përcaktuara edhe në nene të tjera të Kushtetutës, “4, 18, 60, 66, 69, 79, 80, 82, 93, 94, 95, 104, 109, 113, 114, 118, 126, 127, 129, 131, 136, 139, 144, 150 dhe 158.” (shih, rastin [KO47/10](#), parashtrues Naim Rustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit, Aktgjykim i 28 shtatorit 2010, paragrafi 52).
130. Duke pasur parasysh paragrafin 3 të nenit 4 dhe nenin 83 të Kushtetutës, sipas të cilëve, Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit dhe kompetencat e konsiderueshme të dhëna Presidentit të Republikës në bazë të Kushtetutës, Gjykata edhe më parë ka theksuar se “*është e arsyeshme që publiku të marrë me mend se Presidenti i tyre, që “përfaqëson unitetin e popullit” dhe “jo interesat grupore ose interesat politike partiake, do t’i përfaqësojë të gjithë.*” (shih, rastin [KO103/14](#), parashtruese Presidentja e Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 30 qershorit 2024, paragrafët 63 dhe 94).
131. Gjykata gjithashtu sjell në vëmendje Opinionin e Komisionit të Venecias, përmes të cilit ishte specifikuar që: “*Në sistemet parlamentare, statusi më i lartë midis autoriteteve publike i jepet Presidentit, jo sepse ai ose ajo është autoriteti më i fuqishëm, por sepse objektivat që ai/ajo duhet të ndjekë perceptohen si të qëndrojnë mbi dhe përtej atyre të politikave partiake. Nga ana tjetër, për të ndjekur këto objektiva, Kushtetutat i besojnë Presidentit pushtete të përcaktuara në mënyrë specifike, qoftë vetëm formale apo edhe përmbajtësore.*”(shih, Opinionin [CDL-AD\(2019\)019](#) për Shqipërinë lidhur me fushëveprimin e kompetencës së Presidentit për të caktuar datat e zgjedhjeve, miratuar nga Komisioni i Venecias më 11-12 tetor 2019, paragrafi 42).

B. Parimet kushtetuese lidhur me zgjedhjen e Presidentit dhe shpërndarjen e Kuvendit

(i) Dispozitat kushtetuese

132. Gjykata rithekson se në kontekst të procedurës për zgjedhjen e Presidentit sipas përcaktimeve të nenit 86 të Kushtetutës, Gjykata ka interpretuar paragrafët 4 dhe 5 të nenit 86 të Kushtetutës përkitazi me numrin e kandidatëve, votimin në Kuvend dhe pushimin përgjatë procedurës së zgjedhjes së Presidentit (shih, rastin KO29/11, parashtrues Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë, Aktgjykim, i 28 marsit 2011; dhe KO47/16, parashtrues Aida Dërguti, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe 25 deputetë të tjerë, Aktgjykim, i 21 marsit 2016). Përderisa, në kontekst të kompetencës së Presidentit për shpërndarje të Kuvendit, Gjykata ka interpretuar paragrafin 2 të nenit 82 të Kushtetutës në kontekst të kompetencës diskreacionale të Presidentit për shpërndarje të Kuvendit pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë (shih, rastin KO72/20, cituar më lart).

133. Gjykata, në vijim i referohet paragrafit 1 të nenin 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës, kuptimin e të cilit, përkitazi me kompetencën e Presidentit për shpërndarje të Kuvendit, do ta interpretojë në vijim:

“1. Kuvendi shpërndahet në këto raste:

(1) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;

(2) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;

(3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.

2. Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë.”

134. Sipas paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës, të parapara në nënparagrafët (1), (2) dhe (3) të po këtij neni, Kuvendi shpërndahet detyrimisht. Situata e parë është kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Qeverinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e caktimit të mandatarit nga ana e Presidentit. Nëse një situatë e tillë ndodhë, Kuvendi detyrimisht shpërndahet. Situata e dytë është kur të zgjedhurit e popullit vendosin vet, duke votuar me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve, që Kuvendi të shpërndahet. Situata e tretë është kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë Presidentin brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes. Nëse një situatë e tillë ndodhë, Kuvendi detyrimisht shpërndahet.

135. Ashtu siç është theksuar edhe nga Gjykata, e përbashkëta e situatës së parë dhe të tretë, të qartësuara më lart, është pamundësia e Kuvendit që të kryejë detyrimet kushtetuese për formim të Qeverisë ose për zgjedhjen e Presidentit. Në këtë aspekt, Kushtetuta parasheh që nëse Kuvendi nuk arrin të kryejë detyrimet e rëndësishme kushtetuese për të formuar Qeverinë dhe për të zgjedhur Presidentin e Republikës – atëherë Kuvendi duhet të shpërndahet me qëllim të krijimit të një Kuvendi të ri që do të mund t'i kryejë këto detyra të rëndësishme kushtetuese, pas zgjedhjeve të reja dhe të parakohshme. Gjykata po ashtu ka sqaruar se një dallimi tjetër i rëndësishëm në mes të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 82 të Kushtetutës qëndron tek zgjedhja e fjalëve që hartuesit e Kushtetutës kanë përdorur për të treguar mënyrat dhe situatat e shpërndarjes së Kuvendit. Përderisa paragrafi 1 i nenit 82 fillon me fjalët “Kuvendi shpërndahet”; paragrafi 2 i nenit 82 fillon me fjalët: “Kuvendi mund të shpërndahet”. (shih, rastin KO72/20, cituar më lart, paragrafët 384 dhe 397).

136. Në vijim, Gjykata i referohet nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës, i cili përcakton që: (i) Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë; (ii) Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual; (iii) Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidatë për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidat për President të Republikës së Kosovës; (iv) Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit; (v) Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës; dhe (vi) Nëse në votimin e tretë, asnjëri

kandidat nuk zgjedhet President i Republikës së Kosovës, Kuvendi shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.

(ii) Dokumentet Përgatitore të Hartimit të Kushtetutës

137. Bazuar në Dokumentet përgatitore të pranuar nga Gjykata më 14 maj 2020, kjo e fundit, në vijim, do të pasqyrojë evoluimin e përmbajtjeve të neneve 82 [Shpërndarja e Kuvendit] dhe 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës, përgjatë hartimit të Kushtetutës.

Lidhur me shpërndarjen e Kuvendit

138. Ashtu siç është elaboruar edhe në rastin KO72/20, Gjykata sërish vendos theksin në atë se drafti më i hershëm i Kushtetutës që është pjesë e këtij dokumentacioni është ai i 21 majit 2007. Në këtë fazë të hartimit, përpos numrave të neneve, draftet e Kushtetutës nuk përmbajnë tituj të neneve dhe as numërim të paragrafëve përkatës. Shpërndarja e Kuvendit, në nenin 80 të këtij drafti, kishte pesë paragrafë, të cilët përcaktonte se Kuvendi shpërndahet në rastet në vijim: (i) kur në afat prej 60 ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti, nuk mund të formohet Qeveria; (ii) kur për shpërndarje votojnë 2/3 e deputetëve; (iii) kur në afat prej 60 ditësh nga dita e fillimit të procedurës, nuk zgjedhet Kryetari i Kosovës; (iv) me vendim të Presidentit pas konsultimeve me grupet parlamentare të përfaqësuar në Kuvend; dhe (v) shpërndarja e Parlamentit bëhet me dekret të Presidentit.
139. Një dokument, i titulluar “*Pyetësor për Çështjet Kushtetuese: Pika për Udhëzime Politike*”, i 1 qershorit 2007, i cili bazuar në procesverbalet që janë pjesë përbërëse e dokumenteve përgatitore, rezulton të jetë përgatitur nga Komisioni Kushtetues për Grupin Politik dhe Strategjik dhe Ekipin e Unitetit, përfshinë, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit edhe pyetjet në vijim: (i) në pyetjen 11, përkatësisht “*Kush duhet të jetë në gjendje të shpërbëjë Kuvendin dhe të thërret zgjedhje të hershme*”, kishte listuar alternativat vijuese: a) vet-shpërbërje me 2/3 të votave; b) Kryetari i Kosovës; c) me propozim të Qeverisë; d) cila do nga këto më sipër; dhe e) asnjë mundësi për shpërbërjen e Kuvendit (shih, paragrafin 310 të Aktgjykimit në rastin KO72/20).

140. Drafti i radhës i përfshirë në dokumentet përgatitore, është i datës 16 tetor 2007, i titulluar “*Drafti Final i Grupit Punues (GR-III) “Institucionet e Kosovës”*”. Neni 80 i këtij drafti, përkatësisht, Shpërndarja e Kuvendit, reflekton përmbajtjen e njëjtë, me përjashtim të: (i) kombinimit të pikës (ii) me pikën (v), siç është sqaruar më lart; dhe (ii) pikës (iv), me saktësisht, fjalisë “*me vendim të Presidentit pas konsultimit me grupet parlamentare të përfaqësuar në Kuvend*”, e cila, për dallim nga drafti paraprak, nuk reflektohet në këtë draft. Përderisa në draftin e 21 nëntor 2007, neni 80 lidhur me Shpërndarjen e Kuvendit, tashmë i titulluar, ka katër (4) pika të një paragrafi i vetëm, të shënuara si a), b), c) dhe d). Për dallim prej draftit pararendës, pika d) e tij, përmban “*Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti pas votimit të sukseshëm të mosbesimit për Qeverinë*”. Pikat a), b) dhe c) mbeten të njëjta, me pikat (i), (ii), dhe (iii) të draftit pararendës. Drafti i 22 dhjetorit 2007, përkatësisht në nenin 80 të saj, përkitazi me Shpërndarjen e Kuvendit, ka katër pika në të njëjtin paragraf, përfshirë shpërndarjen e Kuvendit, “*kur Kuvendi voton për mosbesimin ndaj Qeverisë*”, në pikën e tij të fundit.

Lidhur me zgjedhjen e Presidentit

141. Në draftin e 21 majit 2007, zgjedhja e Presidentit përcaktohet në nenet 93 dhe 94. Në nenin 93 të këtij drafti përcaktohet që: “*Kryetari i Kosovës zgjedhet nga Kuvendi me votim të fshehtë.*” dhe “*Zgjedhja e Kryetarit bëhet më së voni 30 ditë para përfundimit të mandatit.*” Përderisa në paragrafin 5 të nenit 94 të Kushtetutës përcaktohet që “*Kur*

në votimin e tretë asnjë kandidat nuk zgjedhet Kryetar, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja që duhet të mbahen brenda 45 ditësh.” Në draftet e mëvonshme të hartimit të Kushtetutës, dispozitat për zgjedhjen e Presidentit janë në nenin 84, përmes të cilit ndër tjerash përcaktohet që: “zgjedhja e Presidentit duhet të bëhet jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual” dhe në rast se Presidenti nuk zgjedhet edhe në votimin e tretë, Kuvendi shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda tridhjetë 30 ditësh. Në këtë rast, Gjykata vëren se edhe draftet e mëvonshme deri në miratimin Kushtetutës pasqyrojnë të njëjtin afat për zgjedhjen e Presidentit dhe të njëjtën procedurë sikurse edhe në draftet e mëvonshme, me përjashtim të një numërimi të ri të neneve ose ristrukturim të paragrafëve.

(iii) Analizë krahasimore lidhur me procedurën e zgjedhjes së Presidentit dhe shpërndarjen e Kuvendit

142. Gjykata, duke iu referuar dispozitave kushtetuese përkatëse, të cilat në mënyrë specifike parashohin zgjedhjen e Presidentit nga Kuvendi/Parlamenti, në vijim do të elaborojë: (i) procedurën e votimit; (ii) afatet lidhur me zgjedhjen e Presidentit; dhe (iii) pasojat në rastet kur Kuvendi/Parlamenti përkatës dështon të zgjedhë Presidentin, përkatësisht nëse në rrethana të tilla parashihet ose jo shpërndarja e Kuvendit/Parlamentit.
143. Kushtetutat e Shqipërisë, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Letonisë dhe Maltës, respektivisht parashohin zgjedhjen e Presidentit nga Kuvendi/Parlamenti ose nga një organ elektoral (Gjermani dhe Italia), përmes procedurave që përfshijnë zhvillimin e disa rraundeve të votimit. Dispozitat përkatëse kushtetuese zakonisht kërkojnë që në raundet e para të votimit Presidenti të zgjedhet me shumicë të kualifikuar, siç janë 2/3 apo 3/5 e deputetëve të Kuvendit/Parlamentit. Në rastet kur një shumicë e tillë nuk arrihet, këto rregullime kushtetuese shpesh parashohin zhvillimin e rraundeve të mëvonshme të votimit, brenda të cilave shumica e kërkuar mund të ndryshojë, përkatësisht të ulet deri në shumicë të thjeshtë të votave.
144. Kushtetuta e Shqipërisë, përkatësisht neni 87, ndër tjerash përcakton që (i) për zgjedhjen e Presidentit, Kuvendi zhvillon deri në pesë votime. “*Votimi i parë zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit. Secili nga votimet e tjera zhvillohet jo më vonë se shtatë ditë nga përfundimi pa sukses i votimit pararendës. Votimi quhet i kryer edhe kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë kandidat. Në votimin e dytë, të tretë dhe të katërt mund të paraqiten kandidatë të rinj, sipas kushteve të pikës 1 të këtij neni.*”; (ii) Presidenti zgjedhet në votimin e parë, të dytë ose të tretë kur një kandidat merr jo më pak se tri të pestat (3/5) e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit; (iii) në votimin e katërt dhe të pestë zgjedhet Presidenti kandidat që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit; (iv) “*votimi i pestë zhvillohet kur në votimin e katërt asnjë kandidat nuk ka siguruar shumicën e kërkuar të votave. Votimi i pestë zhvillohet vetëm midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në votimin e katërt.*” [...]; dhe (v) në rast se edhe pas votimit të pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, ose kur pas votimit të katërt pa sukses nuk paraqitet asnjë kandidaturë e re, Kuvendi shpërndahet; (vi) zgjedhjet e reja zhvillohen brenda 45 ditëve nga shpërndarja e tij; dhe (viii) Kuvendi pasardhës e zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij. Përderisa, neni 88 i Kushtetutës së Shqipërisë përcakton që (i) Presidenti zgjedhet për 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë; (ii) mandati i tij/saj përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të pestë nga data e betimit si President; (iii) mandati i Presidentit zgjatet vetëm në kohë lufte dhe për aq kohë sa vazhdon ajo; (iv) procedura për zgjedhjen e Presidentit fillon jo më vonë se 60 ditë para mbarimit të mandatit presidencial paraardhës; dhe (v) kur mandati presidencial përfundon në gjashtë muajt që i paraprijnë fundit të mandatit të Kuvendit ekzistues, procedura për zgjedhjen e

Presidentit fillon jo më vonë se 60 ditë para mbarimit të mandatit të Kuvendit. Neni 91 i Kushtetutës së Shqipërisë përcakton që (i) kur Presidenti i Republikës është në pamundësi të përkohshme për të ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, Kryetari i Kuvendit zë vendin dhe ushtron kompetencat e tij; (ii) në rast se Presidenti nuk mund të ushtrojë detyrën për më shumë se 60 ditë, Kuvendi, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve, vendos dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila vërteton përfundimisht faktin e pamundësisë; dhe (iii) në rast të vërtetimit të pamundësisë, vendi i Presidentit mbetet vakant dhe zgjedhja e Presidentit të ri fillon brenda 10 ditëve nga dita e vërtetimit të pamundësisë.

145. Ligji bazik i Gjermanisë, në nenin 54 të tij parasheh që: Presidenti Federal zgjedhet nga Konventa Federale (paragrafi 1); mandati i Presidentit është pesë (5) vjeçar dhe lejohet rizgjedhja vetëm edhe për një mandat të dytë (paragrafi 2); Konventa Federale përbëhet nga anëtarët e Bundestagut dhe një numër i barabartë anëtarësh të zgjedhur nga parlamentet e Landeve sipas përfaqësimit proporcional (paragrafi 3); Konventa mblidhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para skadimit të mandatit të Presidentit Federal, ose brenda tridhjetë (30) ditësh nga përfundimi i parakohshëm i tij dhe thirret nga Kryetari i Bundestagut (paragrafi 4); Pas përfundimit të një mandati zgjedhor, periudha e përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit (4) të këtij neni fillon kur Bundestagu mblidhet për herë të parë: (paragrafi 5); kandidati që merr shumicën e anëtarëve të Konventës zgjedhet President dhe nëse pas dy raundeve asnjë kandidat nuk e arrin këtë shumicë, në raundin pasues zgjedhet kandidati që merr numrin më të madh të votave (paragrafi 6); dhe procedurat në vijim specifikohen me ligj federal (paragrafi 7).
146. Kushtetuta e Greqisë, në nenin 32 përcakton që (i) Presidenti i Republikës zgjedhet nga Parlamenti të paktën një (1) muaj para skadimit të mandatit të Presidentit në detyrë; (ii) në rast të paaftësisë së përhershme, dorëheqjes, vdekjes ose shkarkimit, seanca për zgjedhjen e Presidentit të ri thirret brenda dhjetë (10) ditësh nga përfundimi i parakohshëm i mandatit; (iii) kandidati që merr dy të tretat (2/3) e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve zgjedhet President; (iv) nëse kjo shumicë nuk arrihet, votimi përsëritet pas pesë (5) ditësh; (v) në rast se as në votimin e dytë nuk arrihet shumica e kërkuar, zhvillohet një votim i tretë pas pesë (5) ditësh, ku kërkohet shumicë prej tre të pestave (3/5) të numrit të përgjithshëm të deputetëve; (vi) në rast se edhe votimi i tretë dështon, Parlamenti shpërndahet brenda dhjetë (10) ditësh dhe shpallen zgjedhje të reja; (vii) Parlamenti i konstituuar pas zgjedhjeve zgjedh Presidentin fillimisht me shumicë prej tre të pestave (3/5) të deputetëve, pastaj me shumicë absolute dhe, nëse as kjo nuk arrihet, me shumicë të thjeshtë ndërmjet dy kandidatëve me më shumë vota; (viii) nëse procedura për zgjedhjen e Presidentit nuk përfundon në kohë, Presidenti në detyrë vazhdon të ushtrojë kompetencat edhe pas skadimit të mandatit, deri në zgjedhjen e pasardhësit.
147. Kushtetuta e Hungarisë, në nenin 11, përcakton që (i) Presidenti i Republikës zgjedhet nga Asambleja Kombëtare me votim të fshehtë, jo më herët se gjashtëdhjetë (60) dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit në detyrë, ose brenda tridhjetë (30) ditësh pas përfundimit të parakohshëm të mandatit; (ii) në raundin e parë President zgjedhet kandidati që merr votat e dy të tretave (2/3) të deputetëve, ndërsa nëse ky raund dështon, zhvillohet raund i dytë ndërmjet dy kandidatëve me votat më të larta, ku Presidenti zgjedhet me shumicën e votave, pavarësisht numrit të deputetëve pjesëmarrës; (iii) në rast se as në raundin e dytë nuk zgjedhet Presidenti, procedura rifillon me nominime të reja, dhe e gjithë procedura e votimit duhet të përfundojë brenda 2 ditëve radhazi.
148. Kushtetuta e Italisë, në nenet 83 dhe 85, përcakton që (i) Presidenti i Republikës zgjedhet nga Parlamenti në seancë, me pjesëmarrjen e tre (3) delegatëve nga çdo rajon

të zgjedhur nga këshillat rajonal; (ii) zgjedhja bëhet me votim të fshehtë dhe kërkon shumicë prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Asamblesë; (iii) pas votimit të tretë, Presidenti zgjedhet me shumicë absolute; (iv) Kryetari i Dhomës së Deputetëve thërret seancën e përbashkët të Parlamentit dhe delegatëve rajonal për zgjedhjen e Presidentit të ri; dhe (v) në rast se Parlamenti është i shpërndarë ose brenda tre (3) muajve para shpërndarjes, zgjedhja zhvillohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga mbledhja e parë e Parlamentit të ri, ndërsa në ndërkohë kompetencat e Presidentit në detyrë zgjaten.

149. Në fund, dhe duke u bazuar edhe në Raportin e Komisionit të Venecias (shih, Shënimin [\[CDL-AD\(2007\)037add4\]](#) për shpërndarjen e Kuvendit, i 8 nëntorit 2007, përgatitur nga Sekretariati i Komisionit të Venecias) Gjykata vëren se në shumë shtete, Kushtetutat parashikojnë që Presidenti, Monarku ose Qeveria kanë kompetencë për të shpërndarë Kuvendin/Parlamentin. Kjo mund të bëhet në mënyrë diskrecionale, sipas rregullave të caktuara ose në situata të specifikuara me Kushtetutë, si dështimi për zgjedhje të Qeverisë, dështimi për miratimin e programit qeverisës ose buxhetit, ose mosbesimi ndaj Qeverisë (shih faqe 2); (ii) nga Kuvendi/Parlamentit; (iii) Përderisa në disa shtete parashikojnë edhe shpërndarje automatike në rrethana të caktuara, si moszgjedhja e Presidentit (shih rastin e Shqipërisë dhe Greqisë, të elaboruar si më sipër), ndryshime kushtetuese ose rezultate negative të referendumit (faqe 6 e Shënimit të Komisionit të Venecias); dhe (iv) disa shtete parashikojnë gjithashtu shpërndarje kombinuere, ku Presidenti vendos pas konsultimeve me Kryeministrin, përfaqësuesit parlamentarë ose grupet parlamentare, ose pas propozimit të Qeverisë (faqe 3 dhe 4).

III. Afatet kushtetuese lidhur me zgjedhjen e Presidentit

150. Gjykata thekson se në praktikën e saj të deritanishme, ajo nuk ka dhënë një interpretim të drejtpërdrejtë dhe përfundimtar lidhur me ndërveprimin mes nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] dhe paragrafit 2 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës. Thënë këtë, Gjykata konsideron se leximi dhe interpretimi i këtyre dy dispozitave kushtetuese nuk mund të bëhet në mënyrë të duhur nëse ato trajtohen jashtë kontekstit kushtetues në të cilin ato duhet të zbatohen. Nëse dy dispozitat e lartcekura lexohen në mënyrë tekstuale dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën, mund të nxirren dy përfundime konkrete: E para, që Kuvendi shpërndahet *ex constitutione* nëse brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nuk arrin të zgjedhë Presidentin, duke filluar nga dita kur nis procedura e zgjedhjes; dhe, e dyta, që Kuvendi ka detyrimin që të paktën tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual të zgjedhë Presidentin e ri.
151. Në këtë mënyrë, për Kuvendin rrjedh e drejta që të ketë në dispozicion gjashtëdhjetë (60) ditë për të zhvilluar procedurën e zgjedhjes së Presidentit, në njërën anë, ndërsa në anën tjetër rrjedh edhe detyrimi që, kur ka President aktual në funksion kushtetues, të zgjedhë pasardhësin e tij jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.
152. Duke marrë për bazë objektin e vlerësimit të çështjes para Gjykatës, kjo e fundit rithekson se çështja thelbësore që shtrohet për shqyrtim është se kur fillon të rrjedhë afati gjashtëdhjetë (60) ditor për zgjedhjen e Presidentit, i përcaktuar me nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës në kontekst të shpërndarjes së Kuvendit i lexuar dhe interpretuar së bashku me afatin detyrues të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës, i cili përcakton që zgjedhja e Presidentit duhet të përfundojë tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual. Rrjedhimisht, Gjykata, në vijim do të elaborojë dhe sqarojë tri rrethanat respektive të cilat e vënë në lëvizje afatin gjashtëdhjetë (60) ditor të përcaktuar me nënparagrafin 3, të paragrafit 1

të nenit 86 të Kushtetutës dhe të lexuar dhe interpretuar në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës.

(i) Afati për zgjedhjen e Presidentit të ri në rastin kur Presidenti aktual është në mandat kushtetues dhe Kuvendi është i konstituuar dhe funksional

153. Gjykata në vijim do të elaborojë çështjen e afatit të zgjedhjes së Presidentit, kur Presidenti aktual është me mandat kushtetues dhe Kuvendi është i konstituuar dhe funksional. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që në paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës përcaktohet që zgjedhja e Presidentit duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual. Ky afat, i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës së Kosovës, është një normë materiale kushtetuese me karakter detyrues. Thënë këtë, Gjykata konsideron që nga kjo dispozitë rrjedh qartë që afati për zgjedhjen e Presidentit/es të ri/re ka karakter detyrues dhe si rrjedhojë e kësaj çdo dispozitë tjetër që ndërlidhet me procedurën e zgjedhjes së Presidentit duhet të interpretohet në harmoni dhe ndërlidhje me këtë afat.
154. Gjykata thekson se afati i specifikuar me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës siguron që procedura për zgjedhjen e Presidentit të fillojë dhe të përfundojë në kohë, duke shmangur kësisoj krijimin e një vakumi institucional, atij të Presidentit të Republikës dhe duke siguruar që Presidenti i zgjedhur menjëherë pas përfundimit të mandatit të Presidentit aktual të fillojë me ushtrimin e funksionit dhe të kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë.
155. Në vijim, dhe ndërlidhur me përcaktimin në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se përfundimi i afatit për zgjedhjen e Presidentit, i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 86, duhet të lexohet dhe interpretohet në ndërlidhje me këtë dispozitë. Sipas interpretimit të përbashkët të këtyre dy dispozitave kushtetuese, procedura për zgjedhjen e Presidentit — e cila nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë — duhet të përfundojë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se procedura për zgjedhjen e Presidentit të Republikës nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë, duke përbërë kohëzgjatjen maksimale të këtij procesi. Në të njëjtën kohë, Kushtetuta përcakton se Presidenti duhet të zgjedhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual. Këto dy afate janë të ndërlidhura, në atë mënyrë që procedura duhet të zhvillohet brenda kufirit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh dhe të përfundojë me zgjedhjen e Presidentit jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.
156. Kësisoj, nëse Kuvendi ka pasur në dispozicion gjashtëdhjetë (60) ditë për të zhvilluar procedurën e zgjedhjes së Presidentit para hyrjes në afatin tridhjetë (30) ditor, afat ky kur Presidenti i ri duhet zgjedhur dhe zgjedhja e tij nuk realizohet, atëherë aktivizohet nënparagrafi 3 i paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës, dhe Kuvendi shpërndahet “*ex constitutione*.” Zgjedhjet e parakohshme duhet të mbahen brenda dyzet e pesë ditësh (45) ditësh, nga dita e shpërndarjes së Kuvendit.
157. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin kur ka një president aktual, mandati i të cilit është në përfundim e sipër, dhe njëkohësisht Kuvendi është i konstituuar dhe funksional, paragrafi 2 i nenit 86 ndërlidhur me nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës përcaktojnë që procedura për zgjedhjen e tij/saj e cila nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë dhe duhet të fillojë përpara dhe të përfundojë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se qëllimi i Kushtetutës, në kontekst të parimeve kushtetuese që ndërlidhen me funksionimin e institucioneve kushtetuese dhe ndarjen e pushteteve është që të sigurojë vazhdimësinë e institucionit të Presidentit, duke garantuar që

zgjedhja e Presidentit të kryhet brenda një afati të qartë dhe pa ndërprerje të mandatit aktual.

158. Në vijim të këtij vlerësimi, Gjykata vë në dukje që përtej afateve të përcaktuara me paragrafin 2 të nenit 86 ndërlidhur me nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës, dispozitat procedurale për zgjedhjen e Presidentit janë të përcaktuara me paragrafët 4, 5 dhe 6 të nenit 86 të Kushtetutës, përmes të cilëve përcaktohet që procedura për zgjedhjen e Presidentit mund të zhvillohet deri në tri (3) raunde. Specifikisht, paragrafët 4 dhe 5 të nenit 86, të Kushtetutës saktësojnë se kandidati që merr të paktën votat e 2/3 (dy të tretave) të të gjithë deputetëve të Kuvendit në raundin e parë ose në raundin e dytë, ose të paktën votat e shumicës të të gjithë deputetëve të Kuvendit në raundin e tretë, do të zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.
159. Gjykata në praktikën gjyqësore të saj, tashmë ka specifikuar që *“për të qenë e vlefshme procedura për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, në raundin e parë dhe të dytë të votimit, të paktën 2/3 (dy te tretat) e të gjithë deputeteve të Kuvendit duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë, ndërsa në raundin e tretë, të paktën shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë, në pajtim me paragrafët 4 dhe 5, të nenit 86, të Kushtetutës.”* (shih, rastin KO47/16, cituar më lart, paragrafi 63).
160. Në vijim, Gjykata i referohet paragrafit 6 të nenit 86 të Kushtetutës, i cili përcakton që: *“Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjedhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.”* Sipas këtij përcaktimi, Gjykata vëren që në rast të dështimit të zgjedhjes së Presidentit edhe në raundin e tretë, Kuvendi shpërndahet sipas Kushtetutës *“ex constitutione”* dhe si rrjedhojë zgjedhjet shpallen dhe mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.

(ii) Afati në kontekst të zgjedhjes së Presidentit kur nuk ka Kuvend të konstituuar dhe funksional

161. Gjykata vëren se Kushtetuta nuk ka specifikuar shprehimisht rrethanën se kur fillon dhe përfundon procedura e zgjedhjes së Presidentit të ri, në rrethanat kur nuk ka një Kuvend të konstituuar dhe funksional, dhe kur gjatë kësaj periudhe përfundon mandati i Presidentit. Ndërlidhur me afatin për konstituimin e Kuvendit, Gjykata tashmë ka konstatuar që bazuar në interpretimin e paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës, Seanca Konstituive e Kuvendit është një akt kushtetues që duhet të përmbushet me sukses brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes së të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit të Kuvendit (shih, rastin KO124/25, cituar më lart, paragrafi 145).
162. Në kontekstin specifik të rrethanave të një Kuvendi të shpërndarë dhe ende të pa konstituuar, Gjykata bazuar në interpretimin si më lart dhe qëllimin e normave kushtetuese, të përcaktuara përmes nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82 ndërlidhur me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës, vlerëson se procedura për zgjedhjen e Presidentit duhet të fillojë nga dita e konstituimit të Kuvendit dhe të përfundojë më së largu brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit.

(iii) Afati dhe zgjedhja e Presidentit kur mandati i tij/saj përfundon para kohe

163. Gjykata, duke iu referuar neneve 90 [Mungesa e Përkohshme e Presidentit] dhe 91 [Shkarkimi i Presidentit] të Kushtetutës, si dhe neneve 9 (Mungesa e Përkohshme e

Presidentit) dhe 10 (Shkarkimi i Presidentit) të Ligjit Nr.03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës, vëren se mandati i Presidentit mund të përfundojë para kohe.

164. Gjykata, në vijim, dhe bazuar në elaborimin si më sipër që ndërlidhet me afatin e zgjedhjes së Presidentit, vëren se qëllimi i Kushtetutës është që të mos krijohet vakum institucional të funksionit të Presidentit dhe të garantojë vazhdimësinë e këtij institucioni përmes fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit të ri. Në rast të përfundimit para kohe të mandatit të Presidentit, procedura për zgjedhjen e Presidentit të ri fillon nga dita kur përfundimi i mandatit të tij/saj para kohe bëhet fakt dhe e njëjta duhet të përfundojë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e fillimit të procedurës.

IV. Vlerësimi dhe interpretimi i Gjykatës lidhur me objektin e kërkesës

A. Thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesave dhe kundërgjyqësive të palëve

165. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në rastin KO72/26, përkatësisht Qeveria, në thelb pretendon se Akti i kontestuar për shpërndarje të Kuvendit (i) përbën shkelje të rëndë të rendit kushtetues, sepse i njëjti është nxjerrë pa u shteruar afati gjashtëdhjetë (60) ditor i përcaktuar në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës; dhe se i njëjti (ii) ka cenuar rëndë parimin e sundimit të ligjit, të drejtat dhe liritë e njeriut, ndarjen e pushteteve, si dhe parimin e demokracisë përfaqësuese. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës argumenton që *“kriteri i pakapërcyeshëm dhe i patjetërsueshëm”* për ta shpërndarë Kuvendin dhe për ta dërguar vendin në zgjedhje është mosarritja e numrit të mjaftueshëm të votave përmes votimit të përcaktuar në tri (3) raundet e votimit për zgjedhjen e Presidentit dhe që sipas parashtruesit në rastin konkret ky proces nuk kishte filluar si rezultat i mospërmbyshjes së kriterit kushtetues për të filluar procedurën e votimit për zgjedhjen e Presidentit. Në vijim, parashtruesi i kërkesës specifikon që: *“procedura për fillimin e zgjedhjes së Presidentit ka filluar më 5 mars 2026, kur Kuvendit i janë paraqitur dy (2) kandidatë për President dhe sipas tij bazuar në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës “Kuvendi këtë procedurë duhet ta përfundojë brenda 60 ditëve [...]”*.
166. Në vijim, parashtruesit e kërkesës KO74/26, përkatësisht tridhjetë e një (31) deputetë pretendojnë se Akti i kontestuar për shpërndarje të Kuvendit është kundërkushtetues për shkak se i njëjti nuk justifikon ndërlidhjen e afatit tridhjetë (30) ditor të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës si dhe afatin gjashtëdhjetë (60) ditor të përcaktuar me nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, ata argumentojnë se *“çfarëdo numërimi ose interpretimi i afatit 60-ditor, përveçse nga dita e nisjes së procedurës, është jashtë germës dhe frymës së Kushtetutës, dhe jashtë kuptimit dhe funksionit të pikës 3 të paragrafit 1 të nenit 82.”* Përderisa Grupi Parlamentar Multietnik në komentet e tyre ndaj kërkesave të parashtruesve të kërkesave theksojnë se Akti i kontestuar për shpërndarje të Kuvendit i nxjerrë nga Presidentja ende pa përfunduar procedura për zgjedhjen e Presidentit dhe pa kaluar gjashtëdhjetë (60) ditë nga fillimi i procedurës për zgjedhjen sipas tyre tejkalon *“kompetencat kushtetuese duke shkelur rolin procedural të Presidentit në sistemet parlamentare”* të përkufizuar me Kushtetutë.
167. Ashtu siç është specifikuar më lart, pretendimet e parashtruesve të kërkesës kundërgjyqësive hihen nga Presidentja dhe Grupi Parlamentar i LDK-së. Presidentja në komentet e saj drejtuar Gjykatës, në thelb thekson se Dekreti për shpërndarjen e Kuvendit i kontestuar nga parashtruesit e kërkesave është (i) në përputhje me Kushtetutën, sepse afati i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës për zgjedhjen e Presidentit të ri ka karakter përfundimtar dhe se çdo dispozitë tjetër duhet të interpretohet në harmoni dhe ndërlidhje me këtë afat përfundimtar, duke shtuar se

pavarësisht momentit kur fillon procedura e zgjedhjes, e njëjta duhet të përfundojë tridhjetë (30) ditë para skadimit të mandatit të Presidentit aktual; (ii) afati përfundimtar për zgjedhjen e Presidentit i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës është i qartë, përfundimtar dhe imperativ dhe se i njëjti është i përcaktuar qartë me gjuhën normative të paragrafit 2 të nenit 86 të Kushtetutës, sipas së cilës shprehjet “*duhet*” dhe “*jo më vonë*” krijojnë detyrim kushtetues i cili nuk lë hapësirë për interpretim diskrecional, dhe përtej kufirit të përcaktuar “*tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual*”; (iii) nuk cenon parimin e ndarjes së pushteteve; përkundrazi, sipas saj, ai kontribuon në forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe balancës ndërmjet pushteteve, “*duke garantuar që Presidentja të përmbushë detyrimin e saj kushtetues për të siguruar funksionimin kushtetues dhe demokratik të institucioneve të Republikës*”; si dhe (iv) nuk ka pasur rrethana objektive apo të jashtëzakonshme të cilat do të pamundësonin zgjedhjen e presidentit të ri para skadimit të afatit përfundimtar, duke shtuar se “*nuk ka pasur përfundim të parakohshëm të mandatit të Presidentes që do të arsyetonte mbështetjen në nenin 82 (1.3); dhe se nuk kanë ekzistuar rrethana të tjera objektive që do ta pamundësonin zgjedhjen e Presidentit para afatit përfundimtar të nenit 86 (2).*”

168. Në vijim, Grupi Parlamentar i LDK-së, në komentet e tyre të parashtruara në Gjykatë, në thelb specifikon se Akti i kontestuar është në përputhje me Kushtetutën sepse (i) në rastin konkret, mandati i Presidentes aktuale skadon më 4 mars 2026; (ii) Kushtetuta nuk përcakton afatin e fillimit të zgjedhjes, duke i lënë hapësirë Kuvendit që këtë proces ta fillojë muaj para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual; (iii) formulimi i paragrafit 2 të nenit 86 të Kushtetutës përmban normë urdhëruese duke vënë theksin te fjala “*duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual*”; (iv) dështimi për të zgjedhur Presidentin e Republikës brenda këtij afati, i hap rrugë shpërndarjes së Kuvendin dhe mbajtjes së zgjedhjeve të reja.

B. Vlerësimi dhe interpretimi i Gjykatës

169. Gjykata thekson se, gjatë shqyrtimit të kërkesave të paraqitura nga palët e autorizuar, ajo ka dhënë interpretimin e saj lidhur me (i) dispozitat përkatëse të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës, të cilat rregullojnë procedurën e zgjedhjes së Presidentit (shih, rastet KO29/11, Aktgjykim i 28 marsit 2011 dhe KO47/16, Aktvendim për Papranueshmëri i 21 marsit 2016); (ii) paragrafin 2 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës, përkatësisht kompetencën diskrecionale të Presidentit për shpërndarjen e Kuvendit të (shih rastin KO72/20, cituar më lart); (iii) paragrafin 2 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] lidhur me interpretimin e afatit kushtetues për konstituimin e Kuvendit (shih, rastin KO124/25, cituar më lart); dhe (iv) dispozitat përkatëse të neneve 70 [Mandati i Deputetëve] dhe 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës lidhur me mandatin e deputetëve [shih, rastin KO47/16, cituar më lart, KO72/20, cituar më lart, paragrafi 357; KO124/25, cituar më lart, paragrafët 122, 123, 130, 143, 181 dhe 190 ; KO193/25 dhe KO196/25, Aktgjykim, i 7 gushtit 2025, paragrafët 110 dhe 169; dhe KO265/25, Aktgjykim, i 30 shtatorit 2025, paragrafi 155).
170. Gjykata sërish thekson se në praktikën e deritanishme gjyqësore nuk ka bërë një interpretim të ndërlidhjes së nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82 dhe paragrafit 2 të nenit 86 të Kushtetutës.
171. Gjykata rithekson se Kushtetuta e Republikës së Kosovës është burimi i autoritetit të çdo pushteti qeverisës dhe ajo përcakton kufijtë e ushtrimit të këtij autoriteti dhe si rrjedhojë të gjitha institucionet kushtetuese gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj, mund të interpretojnë dhe zbatojnë Kushtetutën porse është kompetencë e Gjykatës Kushtetuese si autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës që, kur një çështje bëhet objekt i shqyrtimit dhe gjykimit

kushtetues para saj, që të bëjë vlerësimin dhe interpretimin përfundimtar të normës kushtetuese (shih, rastin [KO207/19](#), parashtres *NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë*, Aktgjykim, i 10 dhjetorit 2020, paragrafi 127).

172. Gjykata poashtu rithekson që struktura e normave kushtetuese, dhe posaçërisht ajo që ndërlidhet me themelimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore duhet të interpretohet në atë mënyrë që të jetësojë dhe jo bllokojë themelimin dhe ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre. Në kontekstin e detyrimit për konstituimin e Kuvendit ajo ka theksuar se të gjitha veprimet që ndërmerren nga deputetët e zgjedhur të Kuvendit duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për shtetin, duke mundësuar që ai të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar (shih, rastin [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 188).
173. Në vijim dhe duke marrë për bazë rëndësinë e funksionit të Presidentit të përcaktuar me Kushtetutë, Gjykata nënvizon se procesi i zgjedhjes së Presidentit, ka peshë të veçantë për rendin kushtetues dhe përbën një moment shumë të rëndësishëm në jetën politike, institucionale dhe shtetërore të Republikës së Kosovës. Kjo për faktin, që Kushtetuta përcakton që Presidenti mishëron unitetin e popullit, përfaqëson shtetin brenda dhe jashtë, si dhe garanton funksionimin demokratik të institucioneve.
174. Së pari dhe në lidhje me procedurën e zgjedhjes së Presidentit, Gjykata, në rastet [KO29/11](#) dhe [KO47/16](#), respektivisht ka interpretuar dispozitat përkatëse të nenit 86 të Kushtetutës të cilat rregullojnë procedurën e zgjedhjes së Presidentit, përfshirë ato që ndërlidhen me çështjen e kuorumit të nevojshëm, siç përcaktohet me paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 86 të Kushtetutës. Gjykata rithekson se parimet e përcaktuara përmes Aktgjykimit në rastin [KO47/16](#) në zhvillimin e procedurës për zgjedhjen e Presidentit, janë të aplikueshme dhe nuk do të angazhohet në interpretimin e mëtejshëm të paragrafëve 3, 4, dhe 5 të nenit 86 të Kushtetutës, të cilët tashmë janë interpretuar përmes Aktgjykimit të lartcekur. Gjykata rikujton që paragrafi 6 i nenit 86 të Kushtetutës përcakton që: *“Nëse në votimin e tretë, asnjëri nga kandidat nuk zgjedhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.”*
175. Së dyti dhe në lidhje mandatin dhe ushtrimin e funksionit të deputetit, Gjykata rikujton që Kushtetuta në nenin 70 [Mandati i Deputetëve] përcakton që deputetët si përfaqësues të zgjedhur të popullit, nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues, si dhe ka përcaktuar në mënyrë specifike bazat për përfundimin apo humbjen e statusit të deputetit. Po ashtu, bazuar në nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës, deputetët marrin përsipër përgjegjësinë që mandatin përfaqësues ta ushtrojnë në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në përputhje me kërkesat formale të përcaktuara në Kushtetutë, ligje dhe rregulloren e Kuvendit (shih, rastin [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafët 130 dhe 190). Sipas Gjykatës, se çka konsiderojnë deputetët se është në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës në aspekt politik dhe në aspekt të politikave publike, është tërësisht në vullnetin dhe vendimin e deputetëve të Kuvendit. Përderisa respektohet Kushtetuta, çdo zgjidhje e të zgjedhurve dhe njëkohësisht përfaqësuesve të popullit, duhet respektuar dhe Kushtetuta përcakton qartë, që deputetët nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues (shih, rastin [KO72/20](#), cituar më lart, paragrafi 357 dhe rastin [KO124/25](#), cituar më lart, paragrafi 181).
176. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në rastin [KO47/16](#), ndër të tjerash ka theksuar se:

“71. Duke adresuar pretendimet e parashtresve, Gjykata se pari rikujton dhe thekson paragrafin 1 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës që “Deputetët e Kuvendit

janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues" si dhe nenin 74 [Ushtimi i Funkcionit] të Kushtetutës që "Deputetet e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit".

72. Në vazhdim, Gjykata vëren se formulimi që "të gjithë 120 deputetet duhet të votojnë", i përmendur në paragrafin 85 të Aktgjykimit të Gjykatës, në rastin KO29/11, duhet kuptuar në ndërlidhje me përmbajtjen e paragrafëve 83 dhe 84 të atij Aktgjykimi. Detyrimet e deputeteve për të marrë pjesë në seancat plenare të Kuvendit janë të rregulluara dhe burojnë nga Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputeteve (ne tekstin e mëtejme: Ligji për Deputetet), Rregullorja e punës së Kuvendit dhe nga Kodi i sjelljes për deputete. Mos përmbushja e detyrimeve të përcaktuara me Ligjin për Deputetet, nuk e zhvlerëson një vendim të Kuvendit për aq sa shumica e nevojshme për marrjen e një vendimi, siç është specifikuar në Kushtetutë, mbahet në Kuvend."

177. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, specifikisht sa i përket procedurës së zgjedhjes së Presidentit, Gjykata vlerëson se Kushtetuta u ka dhënë deputetëve gjithë hapësirën e nevojshme që në kuadër të garancive të mandatit jodetyrues dhe kërkesave për të ushtruar mandatin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës, të gjejnë mënyrën për t'i dhënë shtetit Presidentin e ri, ndërsa popullit përfaqësuesin dhe simbolin e unitetit, në përputhje me procedurën e përcaktuar me Kushtetutë dhe të sqaruar më tej në praktikën gjyqësore (shih, rastet e Gjykatës, KO29/11, cituar më lart dhe KO47/16).
178. Gjykata vlerëson se deputetët duhet të shfrytëzojnë në mënyrë racionale kohën të cilën Kushtetuta u ka vënë në dispozicion për të përmbushur një nga obligimet themelore kushtetuese, atë të zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës. Thënë këtë, Gjykata vlerëson se kjo e drejtë, si dhe kërkesë që rrjedh nga Kushtetuta, shkon në përputhje me funksionin dhe vullnetin e popullit për t'i besuar deputetit zgjedhjen e Presidentit të shtetit.
179. Në vijim, Gjykata rikujton se Kushtetuta ka përcaktuar kohëzgjatje të ndryshme të mandateve kushtetuese për Kuvendin dhe Presidentin, duke paraparë një mandat katër (4) vjeçar për Kuvendin (shih, paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës), ndërsa një mandat pesë (5) vjeçar për Presidentin (shih, paragrafin 2 të nenit 87 [Mandati dhe Betimi] të Kushtetutës). Një rregullim i tillë kushtetues synon të garantojë vazhdimësinë e funksionimit institucional dhe të parandalojë krijimin e vakumeve institucionale, të cilat do të mund të shkaktonin pengesa ose kriza në funksionimin kushtetues të institucioneve shtetërore.
180. Duke iu rikthyer afateve kushtetuese, përkatësisht atyre që ndërlidhen me zgjedhjen e Presidentit dhe shpërndarjen e Kuvendit, ashtu siç është elaboruar edhe më lart, Gjykata rithekson që leximi dhe interpretimi i dy dispozitave kushtetuese, përkatësisht nënparagrafit 3, paragrafit 1 të nenit 82 dhe paragrafit 2 të nenit 86 të Kushtetutës, nuk do të mund të bëhet në mënyrë të duhur në rast se të njëjtat trajtohen jashtë kontekstit në të cilin ato duhet zbatuar. Gjykata, duke iu referuar vlerësimit si më lart, rithekson që nëse këto dy dispozita lexohen në mënyrë tekstuale dhe të ndërlidhura, mund të nxirren dy përfundime. E para që Kuvendi shpërndahet *ex constitutione* nëse brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nuk arrin të zgjedh Presidentin, nga dita kur fillon procedura e zgjedhjes së këtij të fundit. Dhe, së dyti, që Kuvendi ka detyrë që të paktën tridhjetë (30) ditë para se Presidentit aktual dhe në funksion kushtetues t'i skadojë mandati, ta zgjedh Presidentin/en e ri/re.

181. Gjykata vëren që me rastin e nxjerrjes së Dekretit të kontestuar, Presidentja ka specifikuar që afati i përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës është *“imperativ dhe përfundimtar”*. Në mënyrë specifike, Presidentja në komentet e saj ka theksuar se: *“Të gjitha afatet e përcaktuara në Kushtetutë, pra si kohëzgjatja maksimale prej gjashtëdhjetë (60) ditësh e përcaktuar në nenin 82 (1.3), ashtu edhe afati imperativ për përfundimin e procedurës më së largu tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual, i përcaktuar në nenin 86 (2), janë plotësisht në harmoni me njëri tjetrin dhe nuk kanë asnjë kundërthënie. Kohëzgjatja maksimale prej gjashtëdhjetë (60) ditësh është një mundësi procedurale që i është lënë në dispozicion Kuvendit, por e cila duhet të shfrytëzohet gjithmonë deri në detyrimin e përcaktuar në nenin 86 (2), afat ky i cili në asnjë rrethanë nuk mund të tejkalohet. Në rast se Kuvendit i lejohet mundësia të shkelë këtë detyrim të qartë kushtetues, kjo do ta bënte këtë nen totalisht të pazbatueshëm dhe të pavlerë.”*
182. Në lidhje me këtë, Gjykata ka parasysh këtë interpretim, dhe ashtu siç është elaboruar dhe vlerësuar në këtë Aktgjykim, rithekson se Kuvendi ka në dispozicion afatin gjashtëdhjetë (60) ditor përpara hyrjes në periudhën tridhjetë (30) ditore të përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës. Megjithatë, bazuar në elaborimin si më sipër dhe në kontekst të rrethanave të rastit, (i) ndërlidhur me afatin e përcaktuar kushtetues të zgjedhjes së Presidentit kur nuk ka Kuvend të konstituuar dhe funksional dhe (ii) duke iu referuar qëllimit të normave kushtetuese të përcaktuara përmes nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82 në lidhje me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se procedura për zgjedhjen e Presidentit duhet të fillojë nga dita e konstituimit të Kuvendit dhe të përfundojë më së largu brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e fillimit të procedurës për zgjedhjen e Presidentit.
183. Megjithatë, pavarësisht interpretimit të lartcekur që ndërlidhet me afatin tridhjetë (30) ditor, duke marrë për bazë domosdoshmërinë e funksionimit të institucioneve kushtetuese, përkatësisht vazhdimin e funksionimit të institucionit të Presidentit, me mandat dhe pushtet të plotë kushtetues, Gjykata konsideron që Kuvendi nuk ka pasur gjashtëdhjetë (60) ditë në dispozicion, brenda së cilës periudhë duhet zhvilluar dhe përfunduar procedura për zgjedhjen e Presidentit.
184. Në mënyrë specifike, duke iu rikthyer kontekstit të rrethanave aktuale, Gjykata thekson se marrë për bazë faktin që Legjislatura e X-të e Kuvendit të Republikës së Kosovës është konstituuar më 11 shkurt 2026, afati gjashtëdhjetë (60) ditor ka filluar nga kjo datë, dhe është pezulluar/ndaluar në ditën e njëzet e gjashtë (26-të), përkatësisht më 9 mars 2026, ditën kur Gjykata vendosi masën e përkohshme ndaj Dekretit të kontestuar të Presidentes.
185. Prandaj, marrë parasysh faktin e konstituimit të Kuvendit më 11 shkurt 2026, Gjykata, vlerëson se Kuvendi nuk ka arritur të konsumojë periudhën gjashtëdhjetë (60) ditore për zgjedhjen e Presidentit. Rrjedhimisht dhe në kontekst të domosdoshmërisë së vazhdimin të funksionimit të institucioneve shtetërore, të Presidentit dhe Kuvendit, Gjykata vlerëson se Kuvendi i ka në dispozicion edhe tridhjetë e katër (34) ditë për të vazhduar dhe përfunduar procedurën e zgjedhjes së Presidentit të ri.
186. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata, duke pasur parasysh faktin që Kuvendi është konstituuar më 11 shkurt 2026, vlerëson se Kuvendi nuk ka pasur në dispozicion gjashtëdhjetë (60) ditë për të zhvilluar procedurën e zgjedhjes së Presidentit, në përputhje me nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës.
187. Gjykata, po ashtu, vëren që pas përfundimit të periudhës gjashtëdhjetë (60) ditore, si afat brenda të cilit duhet të përmbyllet procedura e zgjedhjes së Presidentit, Kushtetuta

ka përcaktuar qartë që nëse deputetët e Kuvendit dështojnë të përmbushin detyrën kushtetuese të zgjedhjes së Presidentit, Kuvendi shpërndahe *ex constitutione*, dhe si rrjedhojë e kësaj, brenda dyzet e pesë (45) ditësh mbahen zgjedhjet e parakohshme, si rezultat i të cilave zgjedhet një Legjislaturë e re, e cila pas konstituimit të saj do të ketë detyrën kushtetuese për zgjedhjen e Presidentit të ri.

188. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se deputetët duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi kanë edhe tridhjetë e katër (34) ditë për zgjedhjen e Presidentit, Gjykata konkludon se në rast se brenda kësaj periudhe prej tridhjetë e katër (34) ditëve, Kuvendi dështon të zgjedhë Presidentin e ri, bazuar në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës Kuvendi shpërndahe *ex constitutione* dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvend duhet të zhvillohen brenda dyzet e pesë (45) ditësh, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] dhe paragrafit 6 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës.
189. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se në rastin kur konsumohet periudha gjashtëdhjetë (60) ditore dhe Kuvendi dështon të zgjedh Presidentin e ri, mbi Presidentin apo ushtruesin e detyrës së Presidentit bie vetëm detyrimi që të caktojë datën e mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvend.

Përfundim

190. Gjykata, bazuar në leximin dhe interpretimin e paragrafit 2 të nenit 86 të Kushtetutës që përcakton se *“Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual,”* rithekson se ky afat është detyrues dhe përfundimtar, dhe se marrë për bazë karakterin detyrues të këtij afati, i njëjti nuk mund të relativizohet.
191. Megjithatë, duke iu referuar nënparagrafit 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës, përmes të cilit përcaktohet që Kuvendi shpërndahe në rastin kur *“nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës”*, Gjykata marrë për bazë kontekstin specifik të rrethanave të konstituimit të Kuvendit më 11 shkurt 2026, vlerësoi se Kuvendi nuk ka pasur gjashtëdhjetë (60) ditë në dispozicion, brenda të cilës periudhë duhej përfunduar procedura për zgjedhjen e Presidentit. Si rrjedhojë, Gjykata rithekson se interpretimi i saj lidhur me afatet kushtetuese të përcaktuara me nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 2 të nenit 86 të Kushtetutës, për zgjedhjen e Presidentit, ashtu siç është specifikuar në paragrafët 153-162 të këtij Aktgjykimi, mbeten të aplikueshme në të gjitha rastet e zgjedhjes së Presidentit në të ardhmen, përkatësisht procedura për zgjedhjen e Presidentit të ri, e cila nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë duhet të fillojë përpara dhe të përfundojë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.
192. Në fund, Gjykata rithekson që në rast se pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, përmes të cilit përcaktohet që Kuvendi brenda tridhjetë e katër (34) ditëve duhet të vazhdojë dhe përfundojë zgjedhjen e Kreut të Shtetit, Kuvendi dështon të zgjedhë Presidentin/en e ri/re, Kuvendi, bazuar në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 të Kushtetutës shpërndahe *ex constitutione*, dhe për pasojë, zgjedhjet e parakohshme për Kuvend duhet të zhvillohen brenda dyzet e pesë (45) ditësh, pas ditës së shpërndarjes së Kuvendit, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] dhe paragrafit 6 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 29 të Ligjit, dhe rregullat 48 (1) (a) dhe 65 të Rregullores së punës, më 25 mars 2026, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË që Dekreti [nr.24/2026] i 6 marsit 2026 i Presidentes së Republikës së Kosovës nuk prodhon asnjë efekt juridik;
- III. TË KONSTATOJË që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi kanë tridhjetë e katër (34) ditë për të zhvilluar dhe përfunduar procedurën e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës;
- IV. TË KONSTATOJË që në rast se Kuvendi dështon të zgjedhë Presidentin brenda periudhës së përcaktuar në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, bazuar në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi shpërndahet *ex constitutione*, dhe për pasojë, zgjedhjet e parakohshme për Kuvend duhet të zhvillohen brenda dyzet e pesë (45) ditësh, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] dhe paragrafin 6 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- V. TË KONSTATOJË që Vendimi i Gjykatës për vendosjen e masës së përkohshme, i 9 marsit 2026 shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij Aktgjykimi;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VII. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- VIII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Remzije Istrefi - Peci

Nexhmi Rexhepi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 30 mars 2026
Nr. ref.:UK 3005/26

URDHËR PËR KORRIGJIM
të gabimeve teknike në
Aktgjykimin në rastet e bashkuara KO72/26 dhe KO74/26, të 25 marsit 2026

1. Më 25 mars 2026, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), e deklaroi kërkesën të pranueshme në pajtim me nenin 29 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 48 (1) (a) dhe 65 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
2. Në po të njëjtën ditë, u publikua Aktgjykimi në rastet e bashkuara KO72/26 dhe KO74/26 dhe, po atë ditë, iu dërgua parashtruesve të kërkesave.
3. Më 30 mars 2026, Gjykata *ex officio* vërejti disa gabime teknike në tekstin e Aktgjykimit të publikuar në rastet e bashkuara KO72/26 dhe KO74/26, përkatësisht: (i) në pjesën e përbërjes së Gjykatës; (ii) në paragrafin 8; dhe (iii) në paragrafin 22 të këtij Aktgjykimi.
4. Gjykata, duke pasur parasysh këto gabime teknike në Aktgjykimin në rastet e bashkuara KO72/26 dhe 74/26, të 25 marsit 2026, në bazë të rregullit 59 të Rregullores së punës, më 30 mars 2026, nxjerr këtë:

URDHËR

- I. Aktgjykimi në rastet e bashkuara KO72/26 dhe KO74/26, i 25 marsit 2026, në pjesën hyrëse të tij, korrigjohet në versionin gjuhësor në gjuhën shqipe, përkitazi me përbërjen e Gjykatës, si në vijim:

“e përbërë nga:

[...]

Remzije Istefi Peci, gjyqtare,

[...]”

korrigjohet në:

*“e përbërë nga:
[...]
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
[...]”*

- II. Aktgjykimi në rastet e bashkuara KO72/26 dhe KO74/26, i 25 marsit 2026, në paragrafin 8, korrigjohet në versionet gjuhësore në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, lidhur me referencën numerike: “[...] Vendimit [Nr. GJR. KO72/246]”, dhe korrigjohet si në vijim: “[...] Vendimit [Nr. GJR. KO72/26] [...]”. Paragrafi 8 korrigjohet si në vijim:

“Më 9 mars 2026, Kryetari i Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KO72/26] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KO72/26] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Safet Hoxha dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).”

- III. Aktgjykimi në rastet e bashkuara KO72/26 dhe KO74/26, i 25 marsit 2026, në paragrafin 22, korrigjohet në versionet gjuhësore në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, sa i përket datës në hyrje të paragrafit, përkatësisht “26 mars 2026” dhe korrigjohet në “25 mars 2026”, andaj paragrafi 22 korrigjohet si në vijim:

“Më 25 mars 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese lidhur me pranueshmërinë e kërkesave dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe shqyrtimin e saj në merita. Në të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, vendosi (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë, që Dekreti [nr.24/2026] i 6 marsit 2026, i Presidentes së Republikës së Kosovës nuk prodhon asnjë efekt juridik; (iii) të konstatojë, që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi kanë tridhjetë e katër (34) ditë për të zhvilluar dhe përfunduar procedurën e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës; (iv) të konstatojë, se në rast se Kuvendi dështon të zgjedhë Presidentin brenda periudhës së përcaktuar në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, bazuar në nënparagrafin 3 të paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi shpërndahet ex constitutione, dhe për pasojë, zgjedhjet e parakohshme për Kuvend duhet të zhvillohen brenda dyzet e pesë (45) ditësh, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] dhe paragrafin 6 të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (v) të konstatojë, që Vendimi i Gjykatës për vendosjen e masës së përkohshme, i 9 marsit 2026 shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij Aktgjykimi; dhe (vi) të konstatojë, që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.”

- IV. Ky urdhër do t'i bashkëngjitet Aktgjykimit fillestar të Gjykatës, në pajtim me rregullin 59 të Rregullores së punës;
- V. Ky urdhër do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- VI. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Nexhmi Rexhepi